



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 20

28 shkurt

2013

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 5/2013 datë 14.2.2013	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për shkëmbimin dhe mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar.....	799
Ligj nr. 6/2013 datë 14.2.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”	805
Ligj nr. 7/2013 datë 14.2.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9180, datë 5.2.2004 “Për statistikat zyrtare”, të ndryshuar.....	806
Ligj nr. 86/2013 datë 14.2.2013	Për ratifikimin e protokollit opsional të Konventës për të drejtat e fëmijës “Për procedurën e komunikimit”	811
Ligj nr. 87/2013 datë 14.2.2013	Për kategorizimin e prodhimit, emërtimin dhe tregtimin e vajit të ullirit dhe vajit të bërsisë së ullirit	819
Ligj nr. 89/2013 datë 21.2.2013	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për financimin e projektit të burimeve ujore dhe ujitjes....	824
Ligj nr. 90/2013 datë 21.2.2013	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në ndryshimet e neneve të marrëveshjes së themelimit të Bankës së Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim (BSTDB).....	837

LIGJ
Nr. 5/2013

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR
SHKËMBIMIN DHE MBROJTJEN E NDËRSJELLË TË INFORMACIONIT
TË KLASIFIKUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për shkëmbimin dhe mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7957, datë 25.2.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR SHKËMBIMIN DHE MBROJTJEN
RECIPROKE TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, këtu e më poshtë “palët”,

duke rënë dakord për të zhvilluar bisedime mbi çështjet e politikave të sigurisë dhe për të zgjeruar e forcuar bashkëpunimin e tyre reciprok;

duke qenë të ndërgjegjshme për ndryshimet në situatën politike në botë dhe duke njohur rolin e rëndësishëm të bashkëpunimit të tyre reciprok për ruajtjen e paqes, sigurisë ndërkombëtare dhe besimit reciprok;

të bindura që bashkëpunimi i mirë mund të kërkojë shkëmbimin e informacionit të klasifikuar ndërmjet palëve;

me synim garantimin e mbrojtjes reciproke të të gjithë informacionit të klasifikuar, që është klasifikuar nga një palë dhe transferuar palës tjetër;



me dëshirën për të vendosur rregulla për mbrojtjen reciproke të informacionit të klasifikuar, që do të përfshihen të gjitha marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhura ndërmjet palëve dhe të kontratat që u jepen organizmave të palëve, të cilat parashikojnë shkëmbimin e informacionit të klasifikuar,

bien dakord si më poshtë:

Neni 1 **Përkufizime**

Për qëllimin e kësaj marrëveshjeje:

1. “Informacion i klasifikuar” do të thotë:

- Për Republikën e Shqipërisë:

Çdo informacion i klasifikuar “sekret shtetëror”, sipas ligjit, ekspozimi i paautorizuar i të cilit mund të dëmtojë sigurinë kombëtare.

“Siguri kombëtare” do të thotë mbrojtja e pavarësisë, integritetit territorial, rendit kushtetues dhe marrëdhënieve me jashtë të Republikës së Shqipërisë.

- Për Republikën e Kosovës:

“Informacion i klasifikuar” do të thotë çdo informacion dhe material, publikimi i paautorizuar i të cilave do të cenonte në shkallë të ndryshme interesat e sigurisë së Republikës së Kosovës.

“Interesat e sigurisë” u referohen mbrojtjes, veprimtarive të zbatimit të ligjit dhe zbulimit, marrëdhënieve me jashtë apo të sigurisë së Republikës së Kosovës, përfshirë integritetin e saj territorial, integritetin e institucioneve të saj, rregullën kushtetuese, si dhe stabilitetin dhe zhvillimin ekonomik.

2. “Material i klasifikuar” është çdo pjesë makinerie, armësh, pajisje ose mjet i prodhuar apo në procesin e prodhimit, që ruan, përpunon ose transmeton informacion të klasifikuar.

3 “Dokument i klasifikuar” është çdo informacion i regjistruar, pavarësisht nga forma ose karakteristikat e tij fizike, duke përfshirë, pa kufizim, material të shkruar me dorë ose të printuar, kartat e përpunimit të të dhënave dhe shiritat, hartat, tabelat, fotografitë, pikturat, vizatimet, gdhendjet, skicat, shënimet dhe letrat e punës, kopjet e karbonit dhe shiritat me ngjyrë ose riprodhimet me çdo mjet ose proces dhe regjistrimet e tingujve, zërit, magnetike ose elektronike apo optike ose video në çdo formë dhe pajisjet portative për përpunimin automatik të të dhënave me pajisje të palëvizshme të regjistrimit në kompjuter dhe mjetet portative të regjistrimit në kompjuter.

4. “Niveli i klasifikimit të sigurisë” është kategoria që përcakton rëndësinë e informacionit të klasifikuar, shkallën e mbrojtjes reciproke të tij, në përputhje me legjislacionin përkatës të palëve.

5. “Shenjëzimi i klasifikimit” është një shënim mbi një informacion të klasifikuar, që tregon nivelin e klasifikimit të sigurisë.

6. “Pala marrëse” është pala së cilës i transmetohet informacioni ose materiali i klasifikuar.

7. “Pala e origjinës” është pala, e cila prodhon ose/dhe transmeton informacionin ose materialin e klasifikuar.

8. “Palë e tretë” është një shtet ose organizatë ndërkombëtare, që nuk është palë në këtë marrëveshje.

9. “Autoriteti kompetent për sigurinë” është autoriteti përgjegjës për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar dhe për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, në përputhje me legjislacionin përkatës të palëve.

10. “Nevojë për njohje” është domosdoshmëria për të pasur qasje/akses tek informacioni i klasifikuar për përmbushjen e një detyre zyrtare.

11. “Kontraktor” është çdo person fizik ose juridik, që ka zotësinë ligjore për të lidhur kontratë.

12. “Kontratë e klasifikuar” është çdo kontratë e lidhur nga një institucion publik i njëjës prej palëve me një ose më shumë kontraktorë të palës tjetër dhe që përmban informacion të klasifikuar.

13. “Vizitor” është përfaqësuesi zyrtar i një pale që kërkon të vizitojë objektet dhe ambientet e palës tjetër, që kanë lidhje me informacionin ose materialin e klasifikuar të shkëmbyer.

14. “Certifikatë sigurie personeli” ose “leje e sigurisë” është dokumenti zyrtar, i dhënë nga autoriteti kompetent për sigurinë, një shtetasi të një pale, për qasje/akses tek informacioni i klasifikuar, në përputhje me legjislacionin përkatës të palëve.

15. “Certifikatë sigurie industriale” ose “leje e sigurisë për operatorët ekonomikë” është dokumenti zyrtar i dhënë nga autoriteti kompetent për sigurinë, që vërteton se një kontraktor është i autorizuar për qasje/akses tek informacioni i klasifikuar, në përputhje me legjislacionin përkatës të palëve.

16. “Deklasifikimi i informacionit të klasifikuar” është ndryshimi i autorizuar i statusit të informacionit, nga i klasifikuar në të paklasifikuar.

17. “Qasja/aksesi i paautorizuar” është çdo formë e njohjes, e ekspozimit apo e publikimit të informacionit të klasifikuar në kundërshtim me legjislacionin përkatës të palëve.

18. “Shkelja e sigurisë” është çdo veprim ose mosveprim që rezulton ose mund të rezultojë në qasje/akses të paautorizuar në informacionin e klasifikuar.

Neni 2

Nivelet e klasifikimit të sigurisë

Palët bien dakord që nivelet e mëposhtme të klasifikimit të sigurisë janë të barasvlershme dhe përputhen me nivelet e klasifikimit të sigurisë, të përcaktuara në legjislacionin përkatës.

Republika e Shqipërisë	Republika e Kosovës
TEPËR SEKRET	TEPËR SEKRET
SEKRET	SEKRET
KONFIDENCIAL	KONFIDENCIALE
I KUFIZUAR	E KUFIZUAR

Neni 3

Autoritetet kompetente për sigurinë e informacionit të klasifikuar

1. Autoritetet kompetente të sigurisë për palët janë si më poshtë:

- Për Republikën e Shqipërisë

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (Autoriteti i Sigurisë Kombëtare për Informacionin e Klasifikuar).

- Për Republikën e Kosovës

Agjencia e Kosovës për Inteligjencë

2. Autoritetet kompetente të sigurisë informojnë njëra-tjetrën për legjislacionin përkatës dhe zhvillojnë konsultime periodike në lidhje me procedurat e mbrojtjes së informacionit të klasifikuar.

3. Autoritetet kompetente të sigurisë zhvillojnë bisedime me kërkesë të njëjës palë për zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

4. Autoritetet kompetente të sigurisë bashkëpunojnë për trajnime në fushën e informacionit të klasifikuar dhe verifikimin e sigurisë, sipas interesave reciprokë.



Neni 4

Masat e brendshme dhe qasja/aksesi në informacionin e klasifikuar

1. Palët zbatojnë të gjitha masat e përshtatshme për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar që shkëmbehet në bazë të kësaj marrëveshjeje, konform nivelit të klasifikimit të sigurisë, në përputhje me legjislacionin përkatës.

2. Palët njohin dhe konfirmojnë reciprokisht “certifikatën e sigurisë së personelit” ose “lejen e sigurisë” për njohjen e informacionit të klasifikuar.

3. Qasja/aksesi në informacionin e klasifikuar lejohet për ata persona që kanë nevojë për njohje dhe janë të autorizuar sipas legjislacionit përkatës të palëve.

4. Pala marrëse:

a) e përdor informacionin e klasifikuar vetëm për qëllimet e përcaktuara;

b) i jep informacion të klasifikuar një pale të tretë vetëm me pëlqimin paraprak me shkrim të palës së origjinës;

c) siguron mbrojtjen e barasvlershme të informacionit të klasifikuar, në përputhje me nivelin e klasifikimit të sigurisë së dhënë nga pala e origjinës;

d) respekton të drejtat e pronësisë intelektuale dhe të sekretit tregtar që përfshihet në informacionin e klasifikuar.

Neni 5

Shkëmbimi i informacionit të klasifikuar

1. Shkëmbimi i informacionit të klasifikuar kryhet nëpërmjet kanaleve diplomatike, me shërbime të korrierit ushtarak, mjeteve dhe pajisjeve ose çdo mënyrë tjetër të miratuar nga autoritetet kompetente të sigurisë. Pala marrëse konfirmon me shkrim marrjen e informacionit të klasifikuar.

2. Nëse duhet të transmetohet një dërgesë e madhe që përmban informacion të klasifikuar, autoritetet përkatëse kompetente të sigurisë bien dakord dhe aprovojnë me shkrim mjetet e transportit, itinerarin dhe masat e sigurisë për çdo rast të tillë.

3. Shërbimet informative të palëve mund të shkëmbejnë drejtpërdrejt informacion operativ dhe analitik në përputhje me legjislacionin përkatës.

Neni 6

Riprodhimi dhe përkthimi i informacionit të klasifikuar

1. Informacioni i klasifikuar i nivelit “TEPËR SEKRET” riprodhohet dhe përkthehet vetëm me leje me shkrim të palës së origjinës.

2. Informacioni i klasifikuar i riprodhuar mban të njëjtin nivel klasifikimi me origjinalin. Informacioni i klasifikuar i riprodhuar trajtohet në të njëjtën shkallë sigurie si informacioni origjinal.

3. Riprodhimi dhe përkthimi i informacionit të klasifikuar bëhet nga individë të autorizuar dhe të certifikuar përshtatshëm. Informacioni i klasifikuar i përkthyer mban të njëjtin nivel klasifikimi me origjinalin.

Neni 7

Shkatërrimi i informacionit të klasifikuar

1. Informacioni i klasifikuar shkatërrohet në mënyrë që të parandalohet rindërtimi i plotë ose i pjesshëm i tij.

2. Informacioni i klasifikuar i nivelit “TEPËR SEKRET” nuk shkatërrohet. Ai i kthehet palës së origjinës.

3. Në raste krize, gjendjeje të jashtëzakonshme apo emergjencave të tjera civile, në të cilat informacioni i klasifikuar është i pamundur të mbrohet ose të kthehet te pala e origjinës, ai shkatërrohet menjëherë. Pala marrëse njofton palën e origjinës me shkrim në lidhje me shkatërrimin e informacionit të klasifikuar.

Neni 8

Kontrata e klasifikuar

1. Kontrata e klasifikuar lidhet dhe zbatohet në përputhje me legjislacionin përkatës të secilës palë.

2. Palët njohin dhe konfirmojnë reciprokisht “certifikatën e sigurisë industriale” ose “lejen e sigurisë për operatorin ekonomik”, si dhe “certifikatën e sigurisë së personelit” ose “lejen e sigurisë” të lëshuar prej tyre.

3. Në rastet kur “certifikata e sigurisë industriale” ose “leja e sigurisë për operatorin ekonomik” kontraktues nuk është në përputhje me nivelin e klasifikimit të kontratës, autoriteti kompetent i sigurisë i secilës palë i drejtohet me kërkesë palës tjetër për të kryer procedurat e certifikimit përshtatshmërisht.

4. Autoritetet kompetente të sigurisë së palëve i drejtohen me kërkesë të veçantë njëra-tjetrës për të pajisur me “sigurie personeli” ose “leje të sigurisë” personelin shtesë, në rastet e kërkuara për përmbushjen e detyrimeve të një kontrate të klasifikuar.

5. Kontrata e klasifikuar përmban një aneks sigurie si pjesë përbërëse të saj, nëpërmjet të cilit kontraktori detyrohet të marrë masat e nevojshme për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar.

6. Kontrata e klasifikuar e nivelit të klasifikimit të sigurisë “I KUFIZUAR” përmban një dispozitë të përshtatshme për sigurinë, që përcakton masat minimale për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar. Për këto kontrata nuk kërkohet “sigurie industriale” ose “leje sigurie për operatorin ekonomik”.

7. Detyrimet e kontraktorit për të mbrojtur informacionin e klasifikuar, në lidhje me kontratën e klasifikuar përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:

a) përdorimin e informacionit të klasifikuar vetëm për qëllimet që lidhen me objektin e kontratës së klasifikuar;

b) listën e personave, të cilët janë pajisur me “certifikatë sigurie personeli” ose “leje të sigurisë”, që marrin pjesë në realizimin e kontratës;

c) Transmetimin e informacionit të klasifikuar me mjetet e parashikuara në dispozitat e kësaj marrëveshjeje;

d) njoftimin në kohën e duhur të autoritetit kompetent të sigurisë së kontraktorit, për çdo incident ose tentativë të ndodhur ose të dyshuar, që përbën shkelje të sigurisë së informacionit të klasifikuar;

e) mosdhënien e informacionit në kuadër të kontratës së klasifikuar, një pale të tretë pa pëlqimin paraprak me shkrim të palës së origjinës.

8. Kontrata e klasifikuar përmban masat dhe procedurat për vlerësimin e dëmit të shkaktuar nga humbjet e mundshme apo qasje/aksesi i paautorizuar në informacionin e klasifikuar.

9. Për nënkontraktorët vlejnjë të gjitha masat e përcaktuara për kontraktorët.

Neni 9

Vizitat

1. Autoriteti kompetent për sigurinë e palës marrëse lëshon autorizim paraprak për vizitat e vizitorëve që kanë “sigurie personeli” ose “leje sigurie” të përshtatshme, në rast se ata duhet të kenë qasje/akses tek informacioni i klasifikuar ose në ambientet ku ai administrohet.



2. Autoritetet kompetente për sigurinë bien dakord për procedurat e vizitave.
3. Kërkesa për vizitë përmban informacionin e mëposhtëm:
 - a) emrin dhe mbiemrin e vizitorit, datën dhe vendin e lindjes, numrin e pasaportës ose të një dokumenti tjetër identifikimi;
 - b) shtetësinë e vizitorit;
 - c) funksionin/pozitën e vizitorit dhe emërtimin e institucionit që përfaqëson;
 - d) “certifikatën e sigurisë së personelit” ose “lejen e sigurisë” të vizitorit;
 - e) qëllimin, programin e propozuar të punës dhe datën e planifikuar të vizitës;
 - f) emërtimin e institucionit dhe të ambientit që kërkohet të vizitohet;
 - g) të dhëna të tjera, nëse bihet dakord nga autoritetet kompetente për sigurinë.
4. Autoritetet kompetente për sigurinë miratojnë listën e vizitorëve që mund të përsëritin vizitat brenda dymbëdhjetë muajve për qëllimin e përmbushjes së kontratës së klasifikuar.
5. Palët garantojnë mbrojtjen e të dhënave personale të vizitorëve, sipas legjislacionit përkatës të tyre.

Neni 10

Shkeljet e sigurisë

1. Autoriteti kompetent i sigurisë, në shtetin e të cilit ka ndodhur shkelja, njofton autoritetin kompetent të sigurisë së palës tjetër menjëherë dhe siguron kushtet e nevojshme për zhvillimin e hetimit përkatës. Pala tjetër, nëse kërkohet, bashkëpunon në hetim.
2. Autoriteti kompetent i sigurisë i palës së origjinës merr masat e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, në rastin kur shkelja e sigurisë ndodh te një palë e tretë.
3. Pala tjetër njoftohet me shkrim në lidhje me rezultatet përfundimtare të hetimit.

Neni 11

Shpenzimet

Palët mbulojnë shpenzimet e tyre gjatë zbatimit të marrëveshjes.

Neni 12

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje zgjidhet me konsultime dhe negociata ndërmjet palëve pa iu drejtuar ndonjë juridiksioni të jashtëm.

Neni 13

Dispozita të fundit

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, nëpërmjet së cilës palët kanë njoftuar njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, që kërkesat e tyre të brendshme ligjore për hyrjen e saj në fuqi janë përmbushur.
2. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin me shkrim të palëve. Ndryshimet hyjnë në fuqi në pajtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.
3. Kjo marrëveshje lidhet për një afat të pacaktuar kohe. Secila palë mund ta denoncojë këtë marrëveshje, duke i bërë palës tjetër një njoftim me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në këtë rast, kjo marrëveshje shfuqizohet 6 (gjashtë) muaj nga data në të cilën pala tjetër ka marrë njoftimin e denoncimit.
4. Në rastin e shfuqizimit të kësaj marrëveshjeje, i gjithë informacioni i klasifikuar i shkëmbyer ndërmjet palëve, vazhdon të mbrohet në përputhje me dispozitat e saj.

5. Aspekte të tjera teknike të bashkëpunimit mund të rregullohen me pëlqimin e palëve.
Bërë në Prishtinë, më 7.11.2012, në dy kopje origjinale, secila në shqip dhe serbisht ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike.

LIGJ
Nr. 6/2013

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 9946, DATË 30.6.2008 “PËR SEKTORIN E GAZIT NATYROR”¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 14 të ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, bëhen këto ndryshime:

a) Pikat 3 dhe 4 ndryshohen si më poshtë:

“3. ERE i jep licencë për transmetimin e gazit natyror vetëm një personi, për një territor të caktuar. Përjashtim bëhet vetëm për rastet kur në këtë territor është e domosdoshme të shtrihen dhe të kryejnë aktivitetet infrastruktura të transmetimit të gazit me rëndësi strategjike dhe kombëtare, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Dhënia e licencës bëhet mbi bazën e kriterëve të efikasitetit dhe balancës ekonomike për operatorin e sistemit dhe duke siguruar që aktiviteti i licencuar do të kryhet në përputhje me të drejtat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në seksionin I të kreut IV të këtij ligji.

4. ERE i jep licencë për shpërndarjen dhe furnizimin e klientëve tariforë me gaz natyror vetëm një personi, për një zonë të caktuar shërbimi. Përjashtim bëhet vetëm për rastet kur në këtë territor është e domosdoshme të shtrihen dhe të kryejnë aktivitetet infrastruktura të shpërndarjes dhe furnizimit të klientëve tariforë me gaz me rëndësi strategjike dhe kombëtare, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Dhënia e licencës bëhet mbi bazën e kriterëve të efikasitetit dhe balancës ekonomike për operatorin e sistemit dhe duke siguruar që aktiviteti i licencuar do të kryhet në përputhje me të drejtat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në seksionin II të kreut IV të këtij ligji.”.

b) Pas pikës 8 shtohet pika 9 me këtë përmbajtje:

“9. Përcaktimi i zonave të transmetimit dhe të shpërndarjes, të përmendura në pikat 3 dhe 4 të këtij neni, bëhet me udhëzim të ERE-s. Në përcaktimin e zonave të transmetimit dhe shpërndarjes

¹ Ky ligj është përafëruar plotësisht me:

Nenin 24 të Direktivës 2009/73/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 13 korrik 2009 “Mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm për gazin natyror, e cila shfuqizon direktivën 2003/55/KE”. Numri CELEX: 32009L0073, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 211, datë 14.08.2009, faqe 94 – 136.



dhe kushteve të licencës ERE merr në konsideratë kritere teknike dhe ekonomike të efikasitetit dhe balancës ekonomike, zhvillimin e rrjetit dhe të tregut të gazit në vend dhe ndërveprimin ndërmjet sistemeve përbërëse të vendit dhe me ato të rajonit.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7958, datë 25.2.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

**LIGJ
Nr. 7/2013**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 9180, DATË 5.2.2004 “PËR
STATISTIKAT ZYRTARE”, TË NDRYSHUAR²**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9180, datë 5.2.2004 “Për statistikat zyrtare”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 2, shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c) “Sistemi Kombëtar Statistikor” është tërësia e institucioneve dhe organizatave që ushtrojnë aktivitet brenda Republikës së Shqipërisë, të cilat mbledhin, përpunojnë dhe publikojnë statistika zyrtare sipas programit.”.

Neni 2

Në nenin 4, fjalia hyrëse ndryshohet si më poshtë:

“Për të siguruar besueshmërinë e publikut në statistikat zyrtare, INSTAT-i dhe agjencitë statistikore duhet të udhëhiqen nga parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Europiane. Organizimi dhe zbatimi i programit udhëhiqen nga parimet e mëposhtme:”.

² Ky ligj është përafshuar plotësisht me:

Rregulloren (KE) Nr. 223/2009 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 11 mars 2009 “Mbi statistikat evropiane, e cila shfuqizon Rregulloren (KE, Euroatom), Nr. 1101/2008 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit mbi dërgimin e të dhënave, të cilat i nënshtrohen konfidencialitetit statistikor, Zyrës Statistikore të Komuniteteve Europiane, Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 322/97 Mbi Statistikat e Komunitetit dhe Vendimin e Këshillit 89/382/EEC, Euroatom për krijimin e një komisioni mbi programet statistikore të Komuniteteve Europiane”. Numri CELEX: 32009R0223, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 87, datë 31.3.2009, faqe 164 – 173.

Neni 3

Pas nenit 4 shtohet neni 4/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 4/1

Parimet e cilësisë statistikore

Për të siguruar cilësinë e statistikave zyrtare dhe për të ruajtur besimin e publikut në to, INSTAT-i dhe agjencitë statistikore duhet të udhëhiqen nga parimet e mëposhtme:

- a) “rëndësia”, e cila ka të bëjë me shkallën në të cilën statistikën plotësojnë nevojat aktuale dhe të mundshme të përdoruesve;
- b) “saktësia”, e cila i referohet vlerësimeve më të përafërta ndaj vlerave reale të panjohura;
- c) “koha”, e cila i referohet periudhës mes vlefshmërisë së informacionit dhe ngjarjes apo dukurisë që ajo përshkruan;
- ç) “përpikëria”, e cila ka të bëjë me vonesën ndërmjet datës së nxjerrjes së statistikave dhe asaj të parashikuar për t’u nxjerrë këto statistika;
- d) “e drejta e hyrjes” dhe “qartësia”, të cilat u referohen kushteve dhe mënyrave, përmes të cilave përdoruesit mund të marrin, përdorin dhe interpretojnë të dhënat;
- dh) “krahasueshmëria”, e cila i referohet masës së ndikimit të dallimeve në konceptet e aplikuara statistikore, mjetet matëse dhe procedurat e krahasimit të statistikave mes zonave gjeografike, fushave sektoriale apo kohës së kapërcyer;
- e) “koherenca”, e cila i referohet përshtatshmërisë së të dhënave për t’u kombinuar besueshëm në mënyra dhe përdorime të ndryshme.”.

Neni 4

Në nenin 6 pika 3 shkronja “b”, fjala “rezultateve” zëvendësohet me fjalët “statistikave zyrtare”.

Neni 5

Në nenin 7 bëhen këto shtesa e ndryshime:

- a) Në fillim të nenit shtohet pika 1 me këtë përmbajtje:
“1. INSTAT-i është prodhuesi kryesor i statistikave zyrtare në Republikën e Shqipërisë dhe institucioni përgjegjës për koordinimin e funksionimin e Sistemit Kombëtar Statistikor.
Veprimtaria koordinuese përfshin:
 - a) bashkëpunimin me agjencitë statistikore për projektimin dhe zbatimin e programit;
 - b) sigurimin e uniformitetit të metodologjisë së përdorur gjatë kryerjes së vrojtimeve statistikore;
 - c) sigurimin e mbështetjes teknike, në mënyrë që veprimtaria statistikore të përputhet me standardet ndërkombëtare;
 - ç) kontrollimin e zbatimit të cilësisë statistikore, sipas parimeve të përcaktuara në nenin 4/1 të këtij ligji;
 - d) pjesëmarrjen në proceset e krijimit të sistemeve kombëtare statistikore të informatizimit;
 - dh) përfaqësimin e Sistemit Kombëtar Statistikor në sistemin statistikor europian dhe organizatat ndërkombëtare, si dhe mbajtjen e marrëdhënieve me institutet kombëtare të statistikave të vendeve të tjera.”.
- b) Paragrafi ekzistues numërohet si pikë 2.
- c) Shkronja “c” e pikës 2 ndryshohet si më poshtë:



“c) për të siguruar se statistikat në program janë zhvilluar, prodhuar dhe shpërndarë sipas parimeve të parashikuara në këtë ligj.”.

Neni 6

Në nenin 9 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Struktura organizative e INSTAT-it miratohet me urdhër të Kryeministrit, pas propozimit të Këshillit të Statistikave, sipas shkronjës “d” të pikës 1 të nenit 11 të këtij ligji.”.

b) Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Titullari i INSTAT-it emërohet nga Kryeministri, pas kryerjes së një procedure publike rekrutimi nga Këshilli i Statistikave. Mënyra e kryerjes së kësaj procedure, afatet e njoftimit dhe kriteret për vlerësimin e kandidatëve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Pas kryerjes së procedurës, Këshilli i Statistikave ia propozon kandidaturat e përzgjedhura Kryeministrit, duke i shoqëruar me të gjithë dokumentacionin administrativ të procesit.

Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it emërohet për një periudhë pesëvjeçare, me të drejtë riemërimi vetëm një herë.”.

c) Pas pikës 3 shtohen pikat 3/1 dhe 3/2 me këtë përmbajtje:

“3/1. Kandidati për Drejtorin e Përgjithshëm të INSTAT-it duhet të plotësojë këto kritere:

a) të ketë kualifikime profesionale në fushën e statistikave;

b) të ketë kryer studime pasuniversitare;

c) të ketë eksperiencë në punë në funksione drejtuese për një periudhë jo më pak se 5 vjet;

ç) të jetë i njohur për reputacionin dhe kompetencën në fushën e statistikës;

d) të ketë aftësi menaxhuese dhe komunikimi.

3/2. Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it shkarkohet nga Kryeministri, bazuar në propozimet e Këshillit të Statistikave, vetëm kur përmbushen një a më shumë nga këto raste:

a) shkelje të etikës profesionale;

b) shkelje të rënda administrative dhe/ose shpërdorim detyre;

c) për shkaqe sëmundjesh fizike ose mendore, gjë që e bën të paaftë për të kryer funksionet e ngarkuara;

ç) kur dënohet nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

d) kur evidentohen mangësi ose gabime të rënda apo të përsëritura profesionale. Në rast se evidentohen mangësi apo gabime të rënda ose të përsëritura profesionale, vendimmarrja e Këshillit të Statistikave për të propozuar shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT-it bazuar në këtë rast, merret vetëm nëse janë të këtij mendimi, të paktën, 2/3 e numrit total të anëtarëve të Këshillit të Statistikave.”.

ç) Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. INSTAT-i financohet nga Buxheti i Shtetit, si dhe nga të ardhurat e tjera të ligjshme, të cilat regjistrohen në sistemin unik të thesarit.”.

Neni 7

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 10

Statusi dhe përbërja e Këshillit të Statistikave

1. Këshilli i Statistikave përbëhet nga shtatë anëtarë, të cilët emërohen nga Këshilli i Ministrave, duke u bazuar në interesat profesionale për statistikat zyrtare, si dhe në njohuritë mbi metodat statistikore, si përdorues statistikash, siguroes të të dhënave ose për shkak të përfshirjeve të tjera në prodhimin e statistikave.

2. Anëtarët e Këshillit të Statistikave janë përfaqësues të:

- a) Bankës së Shqipërisë (1 anëtar);
- b) Ministrisë së Financave (1 anëtar);
- c) përdoruesve kryesorë të statistikave zyrtare (2 anëtarë);
- ç) botës akademike (1 anëtar);
- d) shoqërisë civile (1 anëtar);
- dh) Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë (1 anëtar).

3. Anëtarët e Këshillit të Statistikave shërbejnë sipas kapaciteteve personale. Ata caktohen për një mandat pesëvjeçar, duke synuar që datat e mbarimit të këtij afati për çdo anëtar të jenë të shpërndara gjatë periudhës pesëvjeçare. Anëtarët kanë të drejtë riemërimi jo më shumë se një herë.

4. Anëtarët e Këshillit të Statistikave mund të shkarkohen nga Këshilli i Ministrave kur kryejnë një ose disa nga shkeljet e mëposhtme:

- a) mungojnë më shumë se dy herë dhe në mënyrë të përsëritur në mbledhje;
- b) ndeshin konflikte interesi me interesat e INSTAT-it;

c) për shkaqe sëmundjesh fizike ose mendore, gjë që i bën të paaftë për të kryer funksionet e ngarkuara;

ç) kur dënohen nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

5. Pas shkarkimit të anëtarit, Këshilli i Ministrave miraton vendimin përkatës për zëvendësimin e tij.

6. Kryetari i Këshillit të Statistikave nuk duhet të jetë përfaqësues apo punonjës i ndonjë ministrie. Kryetari zgjidhet nga anëtarët e Këshillit të Statistikave. Emërimi hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli i Ministrave.

7. Rregulla më të hollësishme për kriteret dhe procedurat e përfaqësimit, përzgjedhjes, emërimit e shkarkimit të anëtarëve, rregullat e funksionimit dhe masa e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave miratohen nga Këshilli i Ministrave.”.

Neni 8

Pas nenit 10 shtohet neni 10/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 10/1

Mbledhja e Këshillit të Statistikave

- 1. Këshilli i Statistikave mblidhet, të paktën, tri herë në një vit kalendarik.
- 2. Kuorumi përbëhet nga, të paktën, pesë anëtarë të Këshillit.
- 3. Sekretariati i Këshillit të Statistikave sigurohet nga INSTAT-i.”.

Neni 9

Në nenin 11 pika 1, pas shkronjës “e” shtohen shkronjat “ë” dhe “f” me këtë përmbajtje:

“ë) vendos e autorizon përditësimin vjetor të programit vetëm për anën praktike të zbatimit të tij dhe informon Këshillin e Ministrave dhe Kuvendin për modifikimet e kryera;

f) harton një raport vjetor për funksionimin e Sistemit Kombëtar Statistikor, duke përfshirë një raport mbi arritjet e programit, për t’ia paraqitur Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit, dhe e bën të disponueshëm për publikun.”.

Neni 10

Në nenin 12, shkronja “d” shfuqizohet.



Neni 11

Pas nenit 12 shtohen nenet 12/1 dhe 12/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 12/1

Bordi Këshillues Statistikor

Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it mund t’i propozojë Këshillit të Statistikave ngritjen e një bordi këshillues statistikor, për të diskutuar çështjet që lidhen me Sistemin Kombëtar Statistikor. Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it, pas argumentimit të nevojave konkrete që ka institucioni për çështje specifike, i propozon Këshillit të Statistikave emrat e anëtarëve, detyrat dhe kohëzgjatjen e punës.

Këshilli i Statistikave ia paraqet Këshillit të Ministrave propozimin për miratimin përfundimtar të ngritjes së bordit këshillues statistikor. Bordi financohet nga buxheti i INSTAT-it.

Neni 12/2

Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën

1. Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën kryen përditësimin dhe përshtatjen e klasifikimeve statistikore ekonomike dhe sociale, në përputhje me klasifikimet statistikore europiane dhe ndërkombëtare.

2. Ngritja, përbërja, rregullat e funksionimit dhe masa e shpërblimit të anëtarëve të Komisionit Kombëtar për Nomenklaturën përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 12

Në nenin 13, pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Të gjitha institucionet publike janë të detyruara të informojnë INSTAT-in për krijimin e çdo dokumentacioni të ri me të dhëna administrative apo për ndryshimin e atyre ekzistuese, si dhe duhet të lejojnë INSTAT-in të hyjë e të përdorë këto të dhëna vetëm për qëllime statistikore.”.

Neni 13

Në nenin 15 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në fund të pikës 2 shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Të gjithë punonjësit e organeve/kontrolluesve, të përmendur në paragrafin e parë të kësaj pike, të cilët vihen në dijeni me të dhënat që përpunojnë gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin e besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit.”.

b) Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.”.

c) Në fjalinë e parë të pikës 4, fjalët “me përjashtim të rastit të të dhënave të pikës 3 të këtij neni” zëvendësohen me fjalët “me përjashtim të rastit të identifikimit të drejtpërdrejtë”.

ç) Fjalja e dytë dhe e tretë e pikës 8 shfuqizohen.

d) Pas pikës 9 shtohet pika 10 me këtë përmbajtje:

“10. Pas përpunimit të plotë të të dhënave të mbledhura nëpërmjet pyetësorëve letër dhe jo më parë se një vit pas publikimit të statistikave zyrtare të prodhuara nëpërmjet përpunimit të këtyre të dhënave, pyetësorët digjen nën mbikëqyrjen e komisionit të ngritur nga INSTAT-i.”.

Neni 14

Në nenin 18, pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:
“4. Të ardhurat nga gjobat derdhen 100 për qind në Buxhetin e Shtetit.”.

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7959, datë 25.2.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

**LIGJ
Nr. 86/2013**

**PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT OPSIONAL TË KONVENTËS PËR TË DREJTAT
E FËMIJËS “PËR PROCEDURËN E KOMUNIKIMIT”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet protokollin opsional i konventës për të drejtat e fëmijës “Për procedurën e komunikimit”.

Neni 2

Në përputhje me nenin 12 paragrafi 1 të protokollit opsional, Republika e Shqipërisë deklaron se pranon kompetencën e komitetit për të marrë dhe shqyrtuar komunikimet, në të cilat një shtet palë pretendon se një shtet tjetër palë nuk përmbush detyrimet e tij, sipas instrumenteve të renditura në këtë paragraf, në të cilat shteti është palë.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7960, datë 25.2.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**



PROTOKOLLI OPSIONAL

I KONVENTËS PËR TË DREJTAT E FËMIJËS “MBI PROCEDURËN E KOMUNIKIMIT”

Shtetet palë të këtij protokollit,

duke marrë në konsideratë se, në përputhje me parimet e shpallura në Kartën e Kombeve të Bashkuara, njohja e dinjitetit të lindur dhe e të drejtave të barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore është themeli i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë;

duke vërejtur se shtetet palë të Konventës për të drejtat e fëmijës (më poshtë e quajtur Konventa) njohin të drejtat e përcaktuara në të për çdo fëmijë brenda juridiksionit të tyre, pa diskriminim të ndonjë lloji, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinionin politik ose opinionet e tjera, origjina kombëtare, etnike ose sociale, prona, aftësia e kufizuar, lindja ose një status tjetër i fëmijës ose i prindërve, ose i kujdestarëve të tij ose të saj ligjorë;

duke rikonfirmuar karakterin universal, pandashmërinë, ndërvarësinë dhe lidhjen midis të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive themelore;

duke rikonfirmuar, gjithashtu, statusin e fëmijës si subjekt i të drejtave dhe si qenie njerëzore me dinjitet dhe kapacitete zhvilluese;

duke pranuar se statusi i varur dhe i veçantë i fëmijëve mund të krijojë vështirësi reale për ta në ushtrim të mjeteve ligjore për shkeljen e të drejtave të tyre;

duke marrë në konsideratë se ky protokoll do të forcojë dhe do të plotësojë mekanizmat kombëtarë dhe rajonalë që lejojnë fëmijët të paraqesin ankesa për shkeljet e të drejtave të tyre;

duke pranuar se interesat më të mira të fëmijës duhet të jenë faktorë parësorë që duhen të respektohen në ushtrimin e mjeteve ligjore për shkeljet e të drejtave të fëmijës dhe se këto mjete ligjore duhet të marrin në konsideratë nevojën për procedura në mbrojtje të fëmijëve të të gjitha niveleve;

duke inkurajuar shtetet palë të zhvillojnë mekanizma të përshtatshëm kombëtarë për t'i dhënë mundësinë një fëmije, të drejtat e të cilit janë shkelur, që të ketë akses ndaj mjeteve ligjore efektive në nivel kombëtar;

duke rikujtuar rolin e rëndësishëm që institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut dhe institucione të tjera të specializuara përkatëse të ngarkuara për nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, mund të luajnë në këtë drejtim;

duke marrë në konsideratë se, me qëllim forcimin dhe plotësimin e këtyre mekanizmave kombëtarë dhe përmirësimin e mëtejshëm të zbatimit të Konventës dhe sipas rastit, protokolleve opsionale të saj mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë me fëmijë dhe mbi përfshirjen e fëmijëve në konflikt të armatosur, do të ishte e përshtatshme që Komitetit për të Drejtat e Fëmijës (më poshtë i quajtur Komiteti), t'i jepet mundësia të kryente funksionet e parashikuara në këtë protokoll,

kanë rënë dakord i më poshtë:

PJESA I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Kompetenca e Komitetit për të Drejtat e Fëmijës

1. Një shtet palë i këtij protokollit pranon kompetencën e Komitetit të parashikuar nga ky protokoll.

2. Komiteti nuk ushtron kompetencën e tij në lidhje me një shtet palë të këtij protokollit për çështje mbi shkeljen e të drejtave të përcaktuara në një instrument në të cilin shteti nuk është palë.

3. Asnjë komunikim nuk merret nga Komiteti nëse ka lidhje me një shtet që nuk është palë e këtij protokollit.

Neni 2

Parimi i përgjithshëm që udhëheq funksionet e Komitetit

Në përmbushjen e funksioneve të dhëna atij nga ky protokoll, Komiteti udhëhiqet nga parimi interesave më të mira të fëmijës. Ai, gjithashtu, merr në konsideratë të drejtat dhe pikëpamjet e fëmijës, duke i dhënë rëndësinë e duhur pikëpamjeve të fëmijës në përputhje me moshën dhe pjekurinë e fëmijës.

Neni 3

Rregullat e procedurës

1. Komiteti miraton rregullat e procedurës që duhet të ndiqen gjatë ushtrimit të funksioneve të dhëna atij nga ky protokoll. Për këtë ai duhet të marrë në konsideratë veçanërisht nenin 2 të këtij protokollit, me qëllim garantimin e procedurave për mbrojtjen e fëmijëve.

2. Komiteti përfshin në rregullat e tij të procedurës, garancitë për parandalimin e manipulimit të fëmijës nga ata që veprojnë në emër të tij ose të saj dhe mund të refuzojë të shqyrtojë ndonjë komunikim që e konsideron të mos jetë në interesat më të mira të fëmijës.

Neni 4

Masat mbrojtëse

1. Një shtet palë merr të gjithë hapat e nevojshëm për të garantuar që individët nën juridiksionin e tij të mos i nënshtrohen asnjë shkeljeje të të drejtave të njeriut, keqtrajtimit ose kërcënimit si pasojë e komunikimeve ose bashkëpunimit me Komitetin sipas këtij protokollit.

2. Identiteti i çdo individit ose grupi individësh të interesuar nuk zbulohet publikisht pa pëlqimin e tyre të shprehur.

PJESA II

PROCEDURA E KOMUNIKIMIT

Neni 5

Komunikimet individuale

1. Komunikimet mund të paraqiten nga ose në emër të një individit ose grupi individësh brenda juridiksionit të një shteti palë, që pretendojnë të jenë viktime të një shkeljeje nga ai shtet palë, të ndonjë prej të drejtave të përcaktuara në ndonjë prej instrumenteve të mëposhtme, në të cilat ai shtet është palë:

a) Konventa;

b) Protokollit opsional i Konventës mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë me fëmijë;

c) Protokollit opsional i Konventës mbi përfshirjen e fëmijëve në konflikt të armatosur.

2. Kur një komunikim paraqitet në emër të një individit ose grupi individësh, ky do të jetë me pëlqimin e tyre nëse autori nuk e justifikon, duke vepruar në emër të tyre pa një pëlqim të tillë.

Neni 6

Masat e përkohshme

1. Në çdo kohë pas marrjes së një komunikimi dhe para se të jetë arritur një përcaktim në themel, Komiteti mund t'i transmetojë shtetit palë të interesuar për shqyrtimin e tij urgjent, një kërkesë që shteti palë të marrë ato masa të përkohshme që mund të jenë të nevojshme në rrethana të



jashtëzakonshme për të shmangur dëmin e mundshëm, të pariparueshëm ndaj viktimës ose viktimave të shkeljeve të dyshuara.

2. Nëse Komiteti ushtron diskrecionin e tij sipas paragrafit 1 të këtij neni, kjo nuk nënkupton një përcaktim mbi pranueshmërinë ose mbi themelin e komunikimit.

Neni 7 **Pranueshmëria**

1. Komiteti e konsideron një komunikim të papranueshëm kur:
 - a) komunikimi është anonim;
 - b) komunikimi nuk është me shkrim;
 - c) komunikimi përbën abuzim me të drejtën e paraqitjes së këtyre komunikimeve ose është i papajtueshëm me dispozitat e Konventës dhe/ose protokolleve opsionale të saj;
 - d) e njëjta çështje është shqyrtuar tashmë nga Komiteti ose është shqyrtuar, ose po shqyrtohet sipas një procedure tjetër hetimore ose të zgjidhjes ndërkombëtare;
 - e) të gjitha mjetet e brendshme ligjore në dispozicion nuk janë shteruar. Ky nuk do të jetë rregull kur zbatimi i mjeteve ligjore vonohet në mënyrë të paarsyeshme ose nuk mund të sjellë ndihmë efektive.
 - f) komunikimi është haptazi i pabazuar ose nuk është bazuar në nivel të mjaftueshëm.
 - g) faktet që i nënshtrohen komunikimit të bërë përpara hyrjes në fuqi të këtij protokollit për shtetin palë të interesuar, nëse ato fakte nuk kanë vazhduar pas asaj date.
 - h) komunikimi nuk paraqitet brenda një viti pas shterimit të mjeteve të brendshme ligjore, me përjashtim të rasteve kur autori mund të vërtetojë se komunikimi nuk mund të paraqitet brenda atij afati kohor.

Neni 8 **Transmetimi i komunikimit**

1. Nëse Komiteti nuk e konsideron një komunikim të papranueshëm pa iu referuar shtetit palë të interesuar, Komiteti do të sjellë sa më shpejt që të jetë e mundur në vëmendjen e shtetit palë të interesuar, çdo komunikim të paraqitur atij sipas fshehtësisë së këtij protokollit.

2. Shteti palë i jep Komitetit shpjegime ose deklarata me shkrim, që qartësojnë çështjen dhe mjetin ligjor, nëse ka, të cilat mund të ketë ofruar. Shteti palë paraqet përgjigjen e tij sa më shpejt që të jetë e mundur dhe brenda një periudhe prej gjashtë muajsh.

Neni 9 **Zgjidhja miqësore**

1. Komiteti vë në dispozicion zyra të përshtatshme për palët e interesuara, me synim arritjen e një zgjidhjeje miqësore të çështjes mbi bazën e respektimit të detyrimeve të përcaktuara në Konventë dhe/ose protokollin opsionale të saj.

2. Një marrëveshje e një zgjidhjeje miqësore, e arritur nën kujdesin e Komitetit, mbyll shqyrtimin e komunikimit sipas këtij protokollit.

Neni 10 **Shqyrtimi i komunikimeve**

1. Komiteti shqyrton komunikimet e marra sipas këtij protokollit sa më shpejt që të jetë e mundur, duke marrë në konsideratë të gjithë dokumentacionin e paraqitur atij, me kusht që ky dokumentacion t'i transmetohet palëve të interesuara.

2. Komiteti kryen takime me dyer të mbyllura gjatë shqyrtimit të komunikimeve të marra sipas këtij protokollit.

3. Nëse Komiteti ka kërkuar masa të përkohshme, ai do të përshpejtojë shqyrtimin e komunikimit.

4. Gjatë shqyrtimit të komunikimeve që pretendojnë shkelje të të drejtave ekonomike, sociale ose kulturore, Komiteti do të shqyrtojë arsyetueshmërinë e hapave të marrë nga shteti palë në përputhje me nenin 4 të Konventës. Për këtë Komiteti do të ketë parasysh që shteti palë të mund të miratojë një sërë masash të mundshme politikash për zbatimin e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore në Konventë.

5. Pas shqyrtimit të një komunikimi, Komiteti do të transmetojë pa vonesë pikëpamjet e tij mbi komunikimin, së bashku me rekomandimet e tij, nëse ka, për palët e interesuara.

Neni 11

Zbatimi

1. Shteti palë shqyrton me kujdes pikëpamjet e Komitetit, së bashku me rekomandimet e tij, nëse ka, dhe i paraqet Komitetit një përgjigje me shkrim, përfshirë informacionin mbi masat e marra dhe të parashikuara, duke marrë parasysh pikëpamjet dhe rekomandimet e Komitetit. Shteti palë paraqet përgjigjen e tij sa më shpejt që të jetë e mundur dhe brenda një periudhe prej gjashtë muajsh.

2. Komiteti mund të ftojë shtetin palë të paraqesë informacion të mëtejshëm rreth masave që shteti palë ka marrë në përgjigje të pikëpamjeve ose rekomandimeve të tij ose zbatimin e një marrëveshjeje për zgjidhje miqësore, nëse ka, duke përfshirë, siç mund të çmohet e nevojshme nga Komiteti, në raportet e mëtejshme të shtetit palë sipas nenit 44 të Konventës, nenin 12 të protokollit opsional mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë me fëmijë ose nenin 8 të protokollit opsional mbi përfshirjen e fëmijëve në konflikt të armatosur, nëse është e zbatueshme.

Neni 12

Komunikimet ndërshtetërore

1. Një shtet palë i këtij protokollit mund të deklarojë në çdo kohë se pranon kompetencën e Komitetit për të marrë dhe shqyrtuar komunikimet, në të cilat një shtet palë pretendon se një shtet tjetër palë nuk përmbush detyrimet e tij, sipas ndonjë prej instrumenteve të mëposhtme, në të cilat shteti është palë:

a) Konventa;

b) Protokollit opsional i Konventës mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë me fëmijë;

c) Protokoll opsional i Konventës mbi përfshirjen e fëmijëve në konflikt të armatosur.

2. Komiteti nuk merr komunikime në lidhje me një shtet palë që nuk ka bërë këtë deklaratë ose komunikim nga një shtet palë, i cili nuk ka bërë një deklaratë të tillë.

3. Komiteti i vë në dispozicion zyra të përshtatshme shteteve palë të interesuara, me synim një zgjidhje miqësore të çështjes mbi bazën e respektimit të detyrimeve të përcaktuara në Konventë dhe protokollet opsionale të saj.

4. Një deklaratë sipas paragrafit 1 të këtij neni depozitohet nga shtetet palë pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili do t'i transmetojë kopje të tyre shteteve të tjera palë. Një deklaratë mund të tërhiqet në çdo kohë, me njoftim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Kjo tërheqje nuk cenon shqyrtimin e ndonjë çështjeje që i nënshtrohet një komunikimi tashmë të transmetuar sipas këtij neni; asnjë komunikim i mëtejshëm nga ndonjë shtet palë nuk merret sipas këtij neni, pasi njoftimi i tërheqjes së deklaratës të jetë marrë nga Sekretari i Përgjithshëm, nëse shteti palë i interesuar nuk ka bërë një deklaratë të re.



PJESA III PROCEDURAT HETIMORE

Neni 13

Procedurat hetimore për shkelje të rënda dhe sistematike

1. Nëse Komiteti merr informacion të besueshëm që tregon shkelje të rënda ose sistematike nga një shtet palë të të drejtave të parashtruara në Konventë ose në protokollet opsionale të saj për shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë e fëmijëve ose për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura, Komiteti fton shtetin palë të bashkëpunojë në shqyrtimin e informacionit dhe për këtë qëllim, të paraqesë vërejtjet pa vonesë në lidhje me informacionin në fjalë.

2. Duke marrë parasysh të gjitha vërejtjet që mund të jenë paraqitur nga shteti palë i interesuar, si dhe çdo informacion tjetër të besueshëm në dispozicion të tij, Komiteti mund të caktojë një ose më shumë nga anëtarët e tij për të kryer një hetim dhe për t'i raportuar urgjentisht Komitetit. Kur autorizohet dhe me pëlqimin e shtetit palë, hetimi mund të përfshijë një vizitë në territorin e tij.

3. Një hetim i tillë kryhet në fshehtësi dhe bashkëpunimi i shtetit palë do të kërkohet në të gjitha fazat e procedimit.

4. Pas shqyrtimit të rezultateve të një hetimi të tillë, Komiteti ia transmeton pa vonesë këto rezultate shtetit palë të interesuar, së bashku me komentet dhe rekomandimet.

5. Shteti palë i interesuar duhet, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe brenda gjashtë muajve nga marrja e rezultateve, komenteve dhe rekomandimeve të transmetuara nga Komiteti, t'i paraqesë Komitetit vërejtjet e tij.

6. Pasi të kenë përfunduar këto procedura në lidhje me një hetim të bërë në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, Komiteti mund, pas konsultimit me shtetin palë të interesuar, të vendosë të përfshijë një përmbledhje të rezultateve të procedimit në raportin e tij të parashikuar në nenin 16 të këtij protokollit.

7. Çdo shtet palë, në kohën e nënshkrimit ose të ratifikimit të këtij protokollit ose të aderimit, të deklarojë se ai nuk e njeh kompetencën e Komitetit të parashikuar në këtë nen në respektim të të drejtave të parashtruara në disa ose të gjitha instrumentet e renditura në paragrafin 1.

8. Çdo shtet palë që ka bërë një deklaratë në përputhje me paragrafin 7 të këtij neni mund, në çdo kohë, ta tërheqë këtë deklaratë me anë të njoftimit të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 14

Zbatimi i procedurave hetimore

1. Komiteti mund, nëse është e nevojshme, pas përfundimit të periudhës gjashtëmujore të referuar në nenin 13, paragrafi 5, të ftojë shtetin palë të interesuar ta informojë atë për masat e marra dhe të parashikuara, në përgjigje të një hetimi të kryer sipas nenit 13 të këtij protokollit.

2. Komiteti mund të ftojë shtetin palë të paraqesë informacion të mëtejshëm në lidhje me ndonjë masë që shteti palë ka marrë në përgjigje të një hetimi të kryer sipas nenit 13, duke përfshirë, siç çmohet e përshtatshme nga Komiteti, në raportet pasuese të shtetit palë sipas nenit 44 të Konventës, nenin 12 të protokollit opsional të Konventës mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë e fëmijëve ose nenin 8 të protokollit opsional të Konventës mbi përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura, nëse është e zbatueshme.

PJESA IV
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 15
Ndihma dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

1. Komiteti mund t'i transmetojë, me pëlqimin e shtetit palë të interesuar, agjencive të specializuara të Kombeve të Bashkuara, fonde dhe programe dhe organeve të tjera kompetente pikëpamjet ose rekomandimet të tij lidhur me komunikimet dhe hetimet që tregojnë një nevojë për këshillim ose ndihmë teknike, së bashku me vërejtjet dhe sugjerimet e shtetit palë, nëse ka, në këto pikëpamje apo rekomandime.

2. Komiteti mund të sjellë në vëmendjen e këtyre organeve, me pëlqimin e shtetit palë të interesuar, çdo çështje që lind nga komunikimet e shqyrtuara nën këtë protokoll që mund t'i ndihmojë ata të vendosin, secili brenda fushës së tij të kompetencës, mbi këshillueshmërinë e masave ndërkombëtare që mund të kontribuojnë për të ndihmuar shtetet palë në arritjen e progresit në zbatim të të drejtave të njohura në Konventë dhe/ose protokollat opsionale të saj.

Neni 16
Raportimi tek Asambleja e Përgjithshme

Komiteti përfshin, në raportin e tij të paraqitur çdo dy vjet Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me nenin 44 (5) të Konventës, një përmbledhje të aktiviteteve të tij, sipas këtij protokollit.

Neni 17
Shpërndarja dhe informimi i protokollit opsional

Çdo shtet palë ndërmerr ta bëjë të ditur gjerësisht dhe ta shpërndajë këtë protokoll dhe të lehtësojë aksesin në informacionin për pikëpamjet dhe rekomandimet e Komitetit, në veçanti në lidhje me çështje që përfshijnë shtetit palë, me mjetet e duhura dhe aktive dhe në formate të aksesueshme si për të rriturit, ashtu edhe për fëmijët, duke përfshirë ata me aftësi të kufizuara.

Neni 18
Nënshkrimi, ratifikimi dhe aderimi

1. Ky protokoll është i hapur për nënshkrim nga çdo shtet që ka nënshkruar, ratifikuar ose aderuar në Konventë ose në secilin prej dy protokolleve opsionale të para të saj.

2. Ky protokoll është subjekt i ratifikimit nga çdo shtet që ka ratifikuar ose aderuar në Konventë ose në secilin prej dy protokolleve opsionale të para të saj. Instrumentet e ratifikimit depozitohen tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

3. Ky protokoll është i hapur për aderim nga çdo shtet që ka ratifikuar ose aderuar në Konventë ose në secilin prej dy protokolleve opsionale të para të saj.

4. Aderimi hyn në fuqi me depozitimin e një instrumenti të aderimit te Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 19
Hyrja në fuqi

1. Ky protokoll hyn në fuqi tre muaj pas depozitimit të instrumentit të dhjetë të ratifikimit ose aderimit.



2. Për çdo shtet që ratifikon këtë protokoll ose që aderon në të, pas depozitimit të instrumentit të dhjetë të ratifikimit ose instrument të aderimit, ky protokoll hyn në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të vet të ratifikimit ose aderimit.

Neni 20

Shkeljet që ndodhin pas hyrjes në fuqi

1. Komiteti ka kompetenca vetëm në lidhje me shkeljet nga shteti palë të çdo të drejte të parashikuar në Konventë dhe/ose dy protokollet opsionale të para të saj që ndodhin pas hyrjes në fuqi të këtij protokoll.

2. Nëse një shtet bëhet palë në këtë protokoll pas hyrjes në fuqi të tij, detyrimet e atij shteti ndaj Komitetit lidhen vetëm me shkeljet e të drejtave të parashikuara në Konventë dhe/ose në dy protokollet opsionale të para të saj që ndodhin pas hyrjes në fuqi të këtij protokoll për shtetin e interesuar.

Neni 21

Ndryshimet

1. Çdo shtet palë mund të propozojë një ndryshim të këtij protokoll dhe ta paraqesë atë te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Sekretari i Përgjithshëm ia komunikon çdo ndryshim të propozuar shteteve palë, me një kërkesë që të njoftohet nëse ata e miratojnë një takim të shteteve palë me qëllim shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve për propozimet. Në rast se, brenda katër muajve nga data e një komunikimi të tillë, të paktën një e treta e shteteve palë e miratojnë një takim të tillë, Sekretari i Përgjithshëm i thërret në takim nën kujdesin e Kombeve të Bashkuara. Çdo ndryshim i miratuar nga një shumicë prej dy të tretave të shteteve palë të pranishme dhe që votojnë, paraqitet nga Sekretari i Përgjithshëm tek Asambleja e Përgjithshme për miratim dhe, pas kësaj, te të gjitha shtetet palë për pranim.

2. Një ndryshim i miratuar dhe i aprovuar në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, hyn në fuqi në ditën e tridhjetë, pasi numri i instrumenteve të pranimit të depozituara arrin dy të tretat e numrit të shteteve palë në datën e miratimit të ndryshimit. Pas kësaj, ndryshimi hyn në fuqi për çdo shtet palë në ditën e tridhjetë pas depozitimit të instrumentit të tij të pranimit. Një ndryshim është detyrues vetëm për ato shtete palë që e kanë pranuar atë.

Neni 22

Denoncimi

1. Çdo shtet palë mund ta denoncojë këtë protokoll në çdo kohë me anë të njoftimit me shkrim të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Denoncimi hyn në fuqi një vit pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

2. Denoncimi nuk cenon zbatimin e vazhdueshëm të dispozitave të këtij protokoll për çdo komunikim të paraqitur, sipas neneve 5 ose 12 ose çdo hetim i nisur sipas nenit 13 para datës efektive të denoncimit.

Neni 23

Depozitari dhe njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm

1. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara është depozitari i këtij protokoll.

2. Sekretari i Përgjithshëm informon të gjitha shtetet për:

- a) nënshkrimet, ratifikimet dhe aderimet sipas këtij protokoll;
- b) datën e hyrjes në fuqi të këtij protokoll dhe të çdo ndryshimi të tij sipas nenit 21;
- c) çdo denoncim sipas nenit 22.

Neni 24
Gjuhët

1. Ky protokoll, tekstet e të cilit, në gjuhën arabe, kineze, angleze, franceze, ruse dhe spanjolle, janë njëloj autentike, depozitohen në arkivat e Kombeve të Bashkuara.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara u përcjell të gjitha shteteve kopje të vërtetuara të këtij protokoll.

LIGJ
Nr. 87/2013

PËR KATEGORIZIMIN E PRODHIMIT, EMËRTIMIN DHE TREGTIMIN E VAJIT TË ULLIRIT DHE VAJIT TË BËRSISË SË ULLIRIT³

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të vendosë rregullat për kategorizimin e prodhimit, emërtimin dhe tregtimin e vajit të ullirit dhe vajit të bërsisë së ullirit në Republikën e Shqipërisë, me qëllim përshtatjen me kërkesat dhe standardet e tregut ndërkombëtar.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet në të gjitha fazat e prodhimit, përpunimit, ambalazhimit, ruajtjes dhe tregimit të vajit të ullirit dhe vajit të bërsisë së ullirit.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Ministri” është ministri, i cili mbulon fushën e ushqimit.

2. “Vaj ulliri” është vaji i përfuar vetëm nga fruti i pemës së ullirit të tipit *Olea europaea*

L. Nga ky përkufizim përjashtohen vajrat e përfuara duke përdorur tretësit apo proceset e riesterifikimit, si dhe çdo përzjerje me vajra të llojeve të tjera.

³ Ky ligj është përafuar pjesërisht me:

Rregulloren e Këshillit (KE) 1234/2007, datë 22 tetor 2007 “Mbi krijimin e një organizmi të përbashkët të tregjeve bujqësore dhe dispozitave të veçanta për disa produkte bujqësore” (Rregullorja e vetme CMO), Numri CELEX: 32007R1234, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 299, datë 16.11.2007, faqe 1- 149.

Rregulloren implementuese të Komisionit (BE), Nr. 29/2012, datë 13 janar 2012 “Për standardet e marketingut të vajit të ullirit”, Numri CELEX: 32012R0029, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 12, datë 14.1.2012, faqe 14 – 21.



3. “Vaj ulliri i virgjër” është vaji i ullirit i përftuar vetëm me mjete mekanike ose mënyra të tjera fizike, nën kushte termike, të cilat nuk sjellin ndryshime në të dhe i cili është trajtuar vetëm me proceset e larjes, presimit, centrifugimit, dekantimit dhe filtrimit.

4. “Vaji i bërsisë së ullirit” është vaji i përftuar nga trajtimi i bërsisë së ullirit me tretës ose me trajtime të tjera fizike, me përjashtim të vajit të përftuar me anë të procesit të riesterifikimit, si dhe të çdo vaji të përftuar nga përzierja me vajra të llojeve të tjera dhe karakteristika të tjera, të përcaktuara për këtë kategori, sipas pikës 1 të nenit 6 të këtij ligji.

5. “Tregtimi me pakicë” është tregtimi i vajrave të konsumatori i fundit.

6. “Panel-test” është një teknikë vlerësimi, e cila bazohet në aftësinë e një grupi degustatorësh shijues, të cilët kanë aftësitë dhe përgatitjen përkatëse për përcaktimin e karakteristikave organo-shqisore të vajrave të ullirit të virgjëra.

Neni 4

Veprimtaria e operatorëve të biznesit

1. Të gjithë personat fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj, të cilët ushtrojnë veprimtari në prodhimin dhe/ose tregtimin e vajit të ullirit në territorin e Republikës së Shqipërisë, u nënshtrohen kërkesave të legjislacionit shqiptar për ushqimin dhe etiketimin, si dhe kërkesave të veçanta, të përcaktuara në këtë ligj.

2. Kushtet e veçanta higjienike për prodhimin, përpunimin, ruajtjen dhe tregtimin e vajit përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 5

Kategoritë e vajit të ullirit dhe të vajit të bërsisë së ullirit

1. Vaji i ullirit kategorizohet në: vaj ulliri i virgjër, vaj ulliri i rafinuar dhe vaj ulliri.

1.1. Vaji i ullirit i virgjër ndahet në vaj të përshtatshëm për konsum dhe vaj të papërshtatshëm për konsum, sipas nënkategorive të mëposhtme:

1.1.1. Vaji i ullirit i virgjër i përshtatshëm për konsum ndahet në:

a) vaj ulliri ekstra i virgjër është vaji i ullirit i virgjër, i cili ka aciditet të lirë, të shprehur si acid oleik, jo më shumë se 0,8 gram për 100 gramë dhe karakteristika të tjera, të përcaktuara sipas pikës 1 të nenit 6 të këtij ligji;

b) vaj ulliri i virgjër është vaji i ullirit i virgjër, i cili ka aciditet të lirë, të shprehur si acid oleik, jo më shumë se 2 gramë për 100 gramë dhe karakteristika të tjera, të përcaktuara sipas pikës 1 të nenit 6 të këtij ligji;

c) vaj ulliri i virgjër i zakonshëm është vaji i ullirit, i cili ka aciditet të lirë, të shprehur si acid oleik, jo më shumë se 3,3 gramë për 100 gramë dhe karakteristika të tjera, të përcaktuara sipas pikës 1 të nenit 6 të këtij ligji.

1.1.2. Vaj i ullirit i virgjër jo i përshtatshëm për konsum njerëzor, i përcaktuar si vaj ulliri i virgjër lampante, është vaji i ullirit, i cili ka aciditet të lirë, të shprehur si acid oleik, më shumë se 3,3 gramë për 100 gramë dhe/ose karakteristika organo-shqisore e karakteristika të tjera të tij, të përcaktuara sipas pikës 1 të nenit 6 të këtij ligji. Ky vaj lejohet të përdoret për qëllime teknike dhe duhet të rafinohet nëse përdoret për konsum njerëzor.

1.2. Vaj ulliri i rafinuar është vaj i ullirit i përftuar nga vajrat e ullirit të virgjër me metodat e rafinimit, të cilat nuk ndryshojnë strukturën fillestare të glicerideve. Ai ka aciditet të lirë, të shprehur si acid oleik, jo më shumë se 0,3 gram për 100 gramë dhe karakteristika të tjera, të përcaktuara sipas pikës 1 të nenit 6 të këtij ligji.

1.3. Vaj ulliri është vaji i përbërë nga një përzierje e vajit të ullirit të rafinuar me vajra të ullirit të virgjër të përshtatshëm për konsum njerëzor. Ky vaj ka aciditet të lirë, të shprehur si acid

oleik, jo më shumë se 1 gram në 100 gramë dhe karakteristika të tjera të tij, të përcaktuara sipas pikës 1 të nenit 6 të këtij ligji.

2. Vaj i bërsisë së ullirit kategorizohet në vaj i bërsisë së ullirit i papërpunuar, vaj i bërsisë së ullirit i rafinuar dhe vaj i bërsisë së ullirit.

2.1. Vaj i bërsisë së ullirit i papërpunuar është vaj i bërsisë së ullirit, karakteristikat e të cilit përcaktohen sipas pikës 1 të nenit 6 të këtij ligji. Ai duhet të rafinohet nëse përdoret për konsum njerëzor ose lejohet për përdorim teknik.

2.2. Vaj i bërsisë së ullirit i rafinuar është vaji i përfutur nga vaji i bërsisë së ullirit të papërpunuar me metodat e rafinimit, të cilat nuk ndryshojnë strukturën fillestare të glicerideve. Ai ka aciditet të lirë, të shprehur si acid oleik, jo më shumë se 0,3 gram për 100 gramë, dhe karakteristika të tjera, të përcaktuara sipas pikës 1 të nenit 6 të këtij ligji.

2.3. Vaj i bërsisë së ullirit është vaji i përbërë nga një përzierje e vajit të bërsisë së ullirit të rafinuar me vajrat e ullirit të virgjër, të përshtatshëm për konsum njerëzor. Ai ka një aciditet të lirë, të shprehur si acid oleik, jo më shumë se 1 gram në 100 gramë, dhe karakteristika të tjera, të përcaktuara sipas pikës 1 të nenit 6 të këtij ligji. Në asnjë rast, kjo përzierje nuk mund të emërtohet “vaj ulliri”.

Neni 6

Karakteristikat e vajit të ullirit

1. Karakteristikat e cilësisë dhe kriteret e natyrshmërisë së vajit të ullirit dhe vajit të bërsisë së ullirit, kategorizuar në nenin 5 të këtij ligji, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Analizat e këtyre treguesve bëhen në laboratorë të autorizuar, sipas metodave të përcaktuara me udhëzim të ministrit.

2. Në çdo rast, për vajin e ullirit të virgjër mund të përcaktohen edhe karakteristikat organo-shqisore, të cilat duhet të jenë vlerësuar duke përdorur metodën e panel-testit.

3. Karakteristikat, sipas pikës 2 të këtij neni, përcaktohen nga komisione të përhershme degustimi, ngritja dhe funksionimi i të cilave bëhet me urdhër të ministrit.

Neni 7

Rregullat e tregimit

Tregtimi i vajit të ullirit të kategorive të përcaktuara në pikën 1 të nenit 5 të këtij ligji, përveç kategorisë së përcaktuar në pikën 1.1.2, si dhe tregtimi i vajit të bërsisë së ullirit të kategorive të përcaktuara në nenin 5 pikat 2.2 dhe 2.3 të këtij ligji, bëhet sipas rregullave të mëposhtme:

a) tregtohet i ambalazhuar dhe i etiketuar, si dhe lejohet të transportohet i pa ambalazhuar vetëm në rastin e marrëdhënies tregtare ndërmjet prodhuesit dhe subjektit ambalazhues;

b) tregtohet te konsumatori i fundit në ambalazhe me kapacitet jo më të madh se 5 litra;

c) ambalazhi duhet të jetë i mbyllur në mënyrë hermetike dhe ky sistem mbyllës të jetë i tillë që nuk mund të rimbyllet përsëri hermetikisht pasi është hapur një herë dhe duhet të etiketohet në përputhje me kërkesat e përgjithshme të etiketimit të produkteve ushqimore, të përcaktuara në legjisllacionin për ushqimin dhe etiketimin, si dhe sipas kërkesave të veçanta të përcaktuara në këtë ligj;

ç) në rastet kur vaji i përcaktuar në këtë nen destinohet për konsum në vende, grumbullime, qendra ose institucione të konsumit kolektiv, të tilla si restorante, spitale, mensa etj., mund të ambalazhohet në kapacitete deri në 30 litra.



Neni 8

Përcaktimi i origjinës

1. Përcaktimi i origjinës dhe i treguesit gjeografik mund të vendoset në etiketë vetëm për kategoritë e vajit të ullirit ekstra të virgjër dhe të vajit të ullirit të virgjër.

2. Kriteret e përcaktimit të origjinës dhe të treguesit gjeografik për vajin e ullirit ekstra të virgjër dhe vajin e ullirit të virgjër, si dhe procedurat e regjistrimit të tyre rregullohen nga legjislacioni përkatës, i cili rregullon çështjet e regjistrimit dhe të mbrojtjes së origjinës dhe treguesve gjeografikë.

Neni 9

Kërkesa të detyrueshme të etiketimit

1. Përcaktimet e dhëna në nenin 5 të këtij ligji për kategoritë e vajit konsiderohen si “emri” me të cilin tregtohet vaji.

2. Etiketimi i vajrave të përcaktuara në nenin 7 të këtij ligji përmban, me shkronja të qarta dhe të paeliminueshme, emrin, sipas përcaktimit të bërë në pikën 1 të këtij neni, si edhe, jo domosdoshmërisht pranë emrit, informacionin për kategorinë e vajit si më poshtë:

a) për vajin me emër “vaj ulliri ekstra i virgjër”, informacioni është:

“vaj ulliri i kategorisë më të lartë, i përftuar direkt nga ullinjtë dhe vetëm me mjete mekanike”;

b) për vajin me emër “vaj ulliri i virgjër”, informacioni është:

“vaj ulliri i përftuar direkt nga ullinjtë dhe vetëm me mjete mekanike”;

c) për vajin me emër “vaj ulliri i përbërë nga vajra ulliri të rafinuara dhe vajra ulliri të virgjra”, informacioni është:

“vaj që përmban vetëm vajra ulliri të rafinuara dhe vajra të përfthuara direkt nga ullinjtë”;

ç) për vajin me emër “vaj i bërsisë së ullirit”, informacioni është:

“vaj që përmban vetëm vajra të përfthuara nga trajtimi i bërsisë së ullirit (produkteve të përfthuara pas ekstraktimit të vajit të ullirit) dhe vajrave të përfthuara direkt nga ullinjtë”; ose

“vaj që përmban vetëm vajra të përfthuara nga përpunimi i vajit të bërsisë së ullirit dhe vajrave të përfthuara direkt nga ullinjtë”.

Neni 10

Tregues jo të detyrueshëm të etiketimit

Përveç detyrimit për përmbushjen e kërkesave të përgjithshme të legjislacionit në fuqi dhe atyre specifike të etiketimit, të përcaktuara në këtë ligj, etiketa e kategorive të vajit, përcaktuar në nenin 7 të këtij ligji, mund të përmbajë dhe treguesit e mëposhtëm:

a) treguesin “vetëm me një presim në të ftohtë”, vetëm për vajin e ullirit ekstra të virgjër ose vajin e ullirit të virgjër, të përftuar në temperaturën nën 27°C, me anë të presimit të parë mekanik të brumit të ullirit, me një sistem ekstraktimi tradicional, duke përdorur presa hidraulike;

b) treguesin “ekstraktim në të ftohtë”, vetëm për vajin e ullirit ekstra i virgjër ose vajin e ullirit të virgjër, të përftuar në temperaturën nën 27°C, me anë të procesit të filtrimit apo centrifugimit të brumit të ullirit;

c) treguesit e karakteristikave organo-shqisore, vetëm në rast se bazohen në rezultatet e përfthuara nga panel-testi;

ç) treguesin e aciditetit apo aciditetit maksimal, vetëm në rast se ai shoqërohet nga treguesi i vlerës së peroksideve, përmbajtjes së dyllit dhe absorbimin ultraviolet, me shkronja të së njëjtës madhësi dhe në të njëjtën fushë pamjeje.

Neni 11

Organet kompetente të kontrollit

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ushtron kontroll, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, të ndryshuar, si dhe në bazë të legjislacionit për inspektimin, për operatorët e biznesit, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në fushën e përpunimit, tregtimit dhe transportit të vajit të ullirit dhe të vajit të bërsisë së ullirit, për përmbushjen e të gjitha normave teknike dhe treguesve cilësorë të përcaktuar në këtë ligj.

Neni 12

Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet

1. Konsiderohen si kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit me gjobë shkeljet e dispozitave të këtij ligji si më poshtë:

a) moszbatimi ose keqpërdorimi i kategorizimit të vajit, sipas këtij ligji, në masën 100 000 - 200 000 lekë;

b) mospërmbushja e kushteve të veçanta higjienike për prodhimin, përpunimin, ruajtjen dhe tregtimin e vajit, sipas pikës 2 të nenit 4 të këtij ligji, në masën 20 000 - 40 000 lekë;

c) përdorimi ose reklamimi i karakteristikave organo-shqisore të vajit të ullirit të virgjër, të cilat nuk janë përcaktuar sipas parashikimeve të nenit 6 të këtij ligji ose janë në kundërshtim me të, në masën 100 000 - 200 000 lekë;

ç) tregtimi i vajit të ullirit të kategorizuar në nenin 5 të këtij ligji, jashtë parametrave për karakteristikat e cilësisë dhe kriteret e natyrshmërisë, të përcaktuara sipas pikës 1 të nenit 6 të këtij ligji, në masën 100 000 - 200 000 lekë;

d) mosrespektimi i kushteve të ambalazhimit të përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të nenit 7 të këtij ligji, në masën 50 000 - 100 000 lekë;

dh) përdorimi i të dhënave gjeografike dhe emërtimeve të vajrave të ullirit, në kundërshtim me dispozitat e nenit 8 të këtij ligji, në masën 100 000 - 200 000 lekë;

e) etiketimi i vajrave të ullirit në kundërshtim me dispozitat e nenit 9 të këtij ligji, në masën 100 000 - 200 000 lekë.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, janë të zbatueshme edhe kundërvajtjet administrative, si dhe masat urgjente e dënimet kryesore apo plotësuese, të përcaktuara në ligjin nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, të ndryshuar, për aq sa plotësojnë dhe pa rënë në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni.

3. Ndarja e të ardhurave nga gjobat administrative bëhet sipas ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

4. Ndaj kontrolleve dhe masave administrative të parashikuara në këtë ligj mund të bëhet ankesë, sipas dispozitave të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, të ndryshuar, dhe legjislacionit për inspektimin.

Neni 13

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 6 pika 1 të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për ushqimin që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 4 pika 2 dhe 6 pika 3 të këtij ligji.



Neni 14
Shfuqizimet

1. Ligji nr. 8944, datë 19.9.2002 “Për prodhimin, emërtimin dhe tregtimin e vajit të ullirit”, shfuqizohet.

2. Aktet nënligjore në zbatim të ligjit nr. 8944, datë 19.9.2002 “Për prodhimin, emërtimin dhe tregtimin e vajit të ullirit”, do të vazhdojnë të mbeten në fuqi për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, deri në daljen e akteve nënligjore, sipas nenit 13 të këtij ligji.

Neni 15
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7961, datë 25.2.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ
Nr. 89/2013

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
(IBRD) PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË BURIMEVE UJORE DHE UJITJES**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për financimin e projektit të burimeve ujore dhe ujitjes, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 21.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7962, datë 27.2.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

Numër huaje _____

MARRËVESHJE HUAJE
(PROJEKTI PËR BURIMET UJORE DHE UJITJEN)
NDËRMJET SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM
datë , 201_

Marrëveshje datë _____, 201_, ndërmjet Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka). Huamarrësi dhe Banka bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Kushtet e përgjithshme, përkufizimet

1.01 Kushtet e përgjithshme (siç përcaktohen në shtojcën bashkëlidhur kësaj marrëveshje) janë pjesë përbërëse e kësaj marrëveshjeje.

1.02 Në përjashtim të rasteve kur kërkohet ndryshe nga konteksti, termat që fillojnë me shkronja të mëdha, të përdorur në këtë marrëveshje, kanë kuptimet e shpjeguara në kushtet e përgjithshme ose në shtojcën e kësaj marrëveshjeje.

Neni 2

Huaja

2.01 Banka bie dakord t'i japë hua Huamarrësit, sipas afateve kohore dhe kushteve të parashikuara në këtë marrëveshje, shumën e tridhjetë e një milionë eurosh ë31, 000,000 euro], shumë e cila mund të konvertohet herë pas here, sipas kursit të këmbimit, në përputhje me kushtet e seksionit 2.07 të kësaj marrëveshjeje (huaja), për të ndihmuar në financimin e projektit të përshkruar në pjesën 1 të kësaj marrëveshjeje (projekti).

2.02 Huamarrësi mund t'i tërheqë të ardhurat nga huaja në përputhje me seksionin IV të pjesës 2 të kësaj marrëveshjeje.

2.03 Tarifa e angazhimit paguhet nga Huamarrësi dhe është e barabartë me çerekun e njëpërqindëshit (0.25%) të shumës së huas.

2.04 Interesi që do të paguhet nga Huamarrësi për secilën periudhë interesi, është i barabartë me nivelin e referencës së monedhës së huas, plus shpërndarjen e fiksuar; me kusht që pas konvertimit të të gjithë shumës së principalit të huas, ose të një pjese të tij, interesi i paguar nga Huamarrësi gjatë periudhës së konvertimit për këto shuma të përcaktohet në përputhje me dispozitat përkatëse të nenit IV të kushteve të përgjithshme. Pavarësisht nga çfarë u specifikua më lart, në rast se mbetet e papaguar çdo lloj shume nga bilanci i tërheqjes së huas dhe në rast se mospagimi vazhdon për një periudhë prej tridhjetë ditësh, atëherë interesi i paguar nga Huamarrësi llogaritet siç parashikohet në seksionin 3.02 (e) të kushteve të përgjithshme.

2.05 Datat e pagesës janë 15 shkurt dhe 15 gusht të çdo viti.

2.06 Shuma principale e huas ripaguhet në përputhje me afatin e amortizimit të parashikuar në pjesën 3 të kësaj marrëveshjeje.

2.07. a) Huamarrësi mund të kërkojë në çdo kohë konvertimet e mëposhtme të huas për të bërë të mundur menaxhimin e kujdesshëm të saj: i) ndryshimin e monedhës së huas për të gjithë shumën e principalit të huas ose të një pjese të tij, të tërhequr ose të patërhequr, në një monedhë të miratuar; ii) ndryshimin e bazës së nivelit të interesit për: A) të gjithë ose një pjesë të principalit të huas të tërhequr dhe të mbetur nga një nivel variabël në një nivel fiks ose e kundërta; ose B) të gjithë pjesën e shumës së principalit të tërhequr dhe të mbetur të huas nga një nivel variabël bazuar në nivelin e referencës dhe shpërndarjes variabël në një nivel variabël bazuar në nivelin fiks të



referencës dhe shpërndarjen e variablit ose e kundërta; ose C) të gjithë shumën e principalit të huas së tërhequr dhe të mbetur nga niveli variabël bazuar në shpërndarjen e variablit në një nivel variabël të bazuar në një shpërndarje fikse.

b) Çdo konvertim i kërkuar sipas paragrafit (a) të këtij seksioni, që pranohet nga Banka, konsiderohet “konvertim”, siç përkufizohet në kushtet e përgjithshme dhe hyn në fuqi, sipas dispozitave në nenin IV të kushteve të përgjithshme dhe të udhëzimeve për konvertimin.

Neni 3 **Projekti**

3.01 Huamarrësi deklaron angazhimin e tij për përmbushjen e objektivave të projektit. Për këtë qëllim, Huamarrësi realizon pjesën 1 dhe 2 të projektit nëpërmjet MBUMK-së, pjesën 3 të projektit nëpërmjet MMPAU-së dhe pjesën 4 të projektit nëpërmjet MBUMK-së dhe MMPAU-së, në përputhje me dispozitat e nenit V të kushteve të përgjithshme.

3.02 Pa kufizim në dispozitat e seksionit 3.01 të kësaj marrëveshjeje dhe në përjashtim të rasteve kur Huamarrësi dhe Banka bien dakord ndryshe, Huamarrësi siguron se projekti kryhet në përputhje me dispozitat e parashikuara në pjesën 2 të marrëveshjes.

Neni 4 **Efektiviteti, përfundimi**

4.01. Kushtet shtesë të efektivitetit përbëhen si më poshtë:

a) Krijimi i një komiteti drejtues të projektit, komitet i cili bashkëdrejtohet nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, i cili do të jetë përgjegjës për: sigurimin e koordinimit ndërinstucional; ofrimin e kontrollit të përgjithshëm të projektit, politikat dhe udhëzimet strategjike për të; miratimin e planeve dhe të buxheteve të zbatimit; rishikimin e progresit të zbatimit të planeve të përmendura; dhe ndihmën në zgjidhjen e çështjeve të zbatimit.

b) Krijimi i një komiteti teknik, me kushtet e punës të pranueshme për Bankën dhe përgjegjës për sigurimin e koordinimit të projektit, aspektet teknike dhe operative.

c) Përcaktimi nga MMPAU-ja dhe MBUMK-ja, përkatësisht për secilën, i një specialisti prokurimesh dhe i një specialisti për menaxhimin financiar, me kualifikime, eksperiencë dhe kushte pune të pranueshme për Bankën.

d) Miratimin nga Huamarrësi, nëpërmjet MMPAU-së dhe MBUMK-së, të një manuali zbatimi të projektit, të përgatitur në përputhje me paragrafin 1 të seksionit V të pjesës 2 të kësaj marrëveshjeje dhe të konfirmuar si të kënaqshëm nga Banka.

4.02. Afati për hyrjen në fuqi është data e ditës së nëntëdhjetë (90) pas datës së kësaj marrëveshjeje.

Neni 5 **Përfaqësimi, adresat**

5.01. Përfaqësuesi i Huamarrësit është Ministri i tij i Financave.

5.02. Adresa e Huamarrësit është:

Ministria e Financave

Nr. 4, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”

Tiranë, Shqipëri

Faksimile:

355-4222-8494

5.03. Adresa e Bankës është:

International Bank for Reconstruction and Development

1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
United States of America

Adresa kablllore:

Teleksi:

Faksimile:

INTBAFRAD

248423(MCI) or

1-202-477-6391

Washington, D.C.

64145(MCI)

Bërë në _____, _____, në ditën dhe vitin e shënuar më sipër.

SHQIPËRIA

Nga: _____

Përfaqësuesi i autorizuar

Emri: _____

Titulli: _____

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga _____

Përfaqësuesi i autorizuar

Emri: _____

Titulli: _____

PJESA 1

PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Objektivi i projektit është të ndihmojë Huamarrësin në: 1. përcaktimin e kuadrit strategjik për menaxhimin e burimeve ujore në nivelin kombëtar dhe në nivelin e baseneve të lumit Drin, Buna dhe Seman; dhe 2. të përmirësojë, në mënyrë të qëndrueshme, performancën e sistemeve të përzgjedhura të ujitjes.

Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

Pjesa 1. Rehabilitimi i digave dhe i sistemeve të ujitjes dhe të kullimit

a) Rehabilitimi dhe modernizimi i digave dhe i sistemeve të përzgjedhura të ujitjes dhe kullimit.

b) i) Përgatitja dhe zbatimi i instrumenteve dhe i masave të garancisë të lidhura me aktivitetet e rehabilitimit dhe të modernizimit, sipas pjesës 1 (a) më lart, duke përfshirë planet e menaxhimit të mbrojtjes mjedisore dhe sociale dhe planet e veprimt për rivendosjet, kur ato janë të aplikueshme; dhe ii) forcimin e kuadrit që mbulon sigurinë e digave bujqësore, rritjen e kapaciteteve, rritjen e ndërgjegjësimit dhe përgatitjen e planeve për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit dhe sigurimin e cilësisë, instrumentet, operimin dhe mirëmbajtjen dhe përgatitjen për rastet e emergjencave.

Pjesa 2. Mbështetja institucionale për ujitjen dhe kullimin

a) Përcaktimi i përgjegjësive për operimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të ujitjes dhe të kullimit ndërmjet aktorëve (duke përfshirë: ministrinë, bordet e kullimit, njësitë e qeverisjes vendore, organizatat e përdoruesve të ujit dhe operatorët privatë) nëpërmjet, *inter alia*:

i) përgatitjes së një strategjie kombëtare për ujitjen dhe kullimin;

ii) zhvillimit të marrëdhënieve bashkëpunuese (përfshirë marrëdhëniet kontraktuale) ndërmjet agjencive, që përfshihen në ofrimin e shërbimeve të konsulencës;

iii) zhvillimit dhe formalizimit të standardeve të ofrimit të shërbimit të ujitjes dhe të kullimit;

iv) zhvillimit dhe zbatimit të projekteve të vogla pilote të partneritetit publik privat, duke kontraktuar operatorët privatë për operimin dhe mirëmbajtjen e skemave të ujitjes dhe të kullimit.

b) Forcimi i kapaciteteve të organizatave që ofrojnë shërbime ujitjeje dhe kullimi dhe të aktorëve (duke përfshirë: ministrinë, bordet e kullimit, njësitë e qeverisjes vendore, organizatat e



përdoruesve të ujit, dhe operatorët privatë), *inter alia*, nëpërmjet sigurimit të bazës materiale dhe të trajnimit në fusha, ku përfshihen menaxhimi i kontratave dhe kontraktimi me operatorë të tjerë, administrimi, menaxhimi financiar, prokurimi, menaxhimi të ujit, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja.

Pjesa 3. Mbështetja institucionale për menaxhimin e integruar të burimeve ujore

Përcaktimi i një kuadri strategjik për menaxhimin e burimeve ujore nëpërmjet, *inter alia*:

a) Përgatitjes së një strategjie të menaxhimit të integruar të burimeve ujore, duke përfshirë: krijimin e një forumi aktorësh për dialog ndërsektorial dhe vendimmarrje nën drejtimin e Këshillit Kombëtar të Ujit; dhe forcimin e kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e integruar të burimeve ujore, të tillë si: Këshilli Kombëtar i Ujit dhe sekretariati i tij teknik dhe këshillat e basenit ujqor, dhe agjencitë e basenit ujqor, dhe të baseneve të Drinit, Bunës dhe të Semanit.

b) Përgatitjes së planeve të menaxhimit të baseneve ujore për basenet e Drinit-Bunës dhe Semanit, duke përfshirë identifikimin e masave strukturore dhe jostrukturore për përmirësimin e cilësisë së menaxhimit të integruar të burimeve ujore dhe për të forcuar kapacitetin për të zbatuar planet e përmendura nëpërmjet ofrimit të trajnimit dhe mallrave për Agjencitë e Basenit Lumor dhe për rehabilitime të vogla të zyrave të tyre.

c) Krijimit të një baze të dhënash të konsoliduar për burimet ujore, e cila do të përdoret si bazë për planifikimin dhe programimin e burimeve.

Pjesa 4. Mbështetja për zbatim

Ofrimi i mbështetjes për zbatimin e projektit, duke përfshirë ofrimin e ndihmës teknike, trajnimin, bazën materiale, krijimin dhe zbatimin e një sistemi të menaxhimit të informacionit bazuar në performancë.

PJESA 2

ZBATIMI I PROJEKTIT

Seksioni I. Kuadri i zbatimit

A. Kuadri institucional

1. Huamarrësi siguron, për qëllimet e realizimit të projektit, strukturat e mëposhtme, me kushtet e punës, stafin dhe burimet e tjera të pranueshme për Bankën, gjatë të gjithë kohës së zbatimit të projektit:

a) Komitetin drejtues të projektit, të krijuar në përputhje me seksionin 4.01(a) të kësaj marrëveshjeje.

b) Komitetin teknik, të krijuar në përputhje me seksionin 4.01(b) të kësaj marrëveshjeje.

c) Skuadrën e menaxhimit të projektit, të krijuar brenda MBUMK-së dhe MMPAU-së, përgjegjëse për menaxhimin e përditshëm të projektit, koordinimin e partnerëve të projektit, Bankën, bashkëfinancuesit, monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve të projektit, përgatitjen e planit dhe të buxhetit vjetor të zbatimit, përditësimin e planit të prokurimeve dhe përgatitjen e dokumenteve të prokurimit, përgatitjen e raporteve financiare dhe të progresit dhe mbajtjen e dosjeve të dokumenteve të projektit.

B. Antikorrupsioni

Huamarrësi siguron që projekti realizohet në përputhje me dispozitat e udhëzimeve antikorrupsion.

C. Garancitë

Mbrojtja e mjedisit dhe rivendosja

1. Huamarrësi, nëpërmjet MBUMK dhe MMPAU, kryen dhe bën të mundur kryerjen e veprimeve të mëposhtme: a) zbatimin e kuadrit të mbrojtjes mjedisore dhe sociale; dhe b) përgatitjen dhe dërgimin në Bankë për miratim të planeve të menaxhimit të mbrojtjes mjedisore dhe sociale të zonave specifike (përfshirë menaxhimin e dëmtuesve të bimëve) në përputhje me kuadrin e mbrojtjes

mjedisore dhe sociale; dhe c) zbatimin e planeve të sipërpërmendura për menaxhimin mjedisor dhe social të zonave të caktuara, të miratuara nga Banka, të gjitha të kënaqshme për Bankën dhe të nevojshme për të siguruar zbatimin e projektit në përputhje me praktikat dhe standardet mjedisore.

2. Pa u kufizuar në paragrafin 1 të këtij seksioni I.C, Huamarrësi nuk e fillon tenderimin për punimet e projektit derisa Banka të ketë miratuar planin specifik të menaxhimit mjedisor dhe social të lidhur me këto punime, në përputhje me dispozitat e përmendura në paragrafin 1.

3. Huamarrësi, nëpërmjet MBUMK-së dhe MMPAU-së:

a) merr të gjitha masat e nevojshme për të minimizuar, për aq sa është e mundur, çdo humbje jovullnetare të strehimit, humbje të asetëve produktive ose aksesit në asetet produktive, ose humbje në të ardhura, ose mjete të tjera jetese të njerëzve, në mënyrë të përkohshme ose të përhershme, gjatë realizimit të projektit; dhe

b) në rastet ku zbatimi i projektit ose modifikimi/përfundimi i projektit ose i punimeve të projektit çojnë në zhvendosje të njerëzve, para fillimit të punimeve të lidhura me këtë zbatim, modifikim ose përfundim, i jep Bankës për rishikim dhe miratim një plan veprimi rivendosjeje në një zonë specifike, të përgatitur në përputhje me parimet dhe procedurat e parashikuara në kuadrin e politikave të rivendosjes dhe, më pas, zbatimin në mënyrë të kënaqshme për Bankën (ku përfshihet pagimi i plotë i kompensimit për të gjithë personat e zhvendosur, me përjashtim të rasteve kur bihet dakord ndryshe), të këtyre planeve veprimi rivendosjeje për zonat specifike, siç miratohet nga Banka; dhe

4. Huamarrësi, nëpërmjet MBUMK-së dhe MMPAU-së:

a) I vë në dispozicion dhe bën të mundur vënien në dispozicion të Bankës, për miratimin e saj paraprak, të çdo propozimi, modifikimi ose heqjeje të plotë ose të pjesshme, të: i) kuadrit të sigurimit mjedisor dhe social; ii) planeve për menaxhimin mjedisor dhe social për zona specifike, të përgatitura dhe të miratuara nga banka në përputhje me paragrafin 1 të seksionit I.C; iii) kuadrit të politikave të rivendosjes; dhe iv) planet e veprimit të rivendosjes në zonat specifike, të përgatitura dhe të miratuara nga Banka në përputhje me paragrafin 2 të këtij seksioni I.C; dhe

b) Zbaton ose bën të mundur zbatimin e vetëm të atyre modifikimeve ose heqjeve për të cilat Banka bie dakord.

5. Huamarrësi, nëpërmjet MBUMK-së dhe MMPAU-së:

a) Siguron politika dhe procedura të përshtatshme për të lejuar monitorimin dhe vlerësimin, në përputhje me udhëzimet e pranuar nga Banka, për zbatimin e: i) kuadrit të mbrojtjes mjedisore dhe sociale; ii) planet e menaxhimit mjedisor dhe social për zonat specifike, të miratuara nga Banka në përputhje me paragrafin 1 të këtij seksioni I.C; iii) kuadrin e politikave të rivendosjes; dhe iv) planet e veprimit të rivendosjes për zona specifike, të përgatitura dhe të miratuara nga Banka në përputhje me paragrafin 2 të këtij seksioni I.C, dhe arritjen e objektivave të secilit nga instrumentet e sipërpërmendura; dhe

b) Përgatit, sipas kushteve të punës për Bankën, dhe i jep Bankës rezultatet e aktiviteteve të monitorimit dhe të vlerësimit në lidhje me secilin nga instrumentet e përmendura në nënparagrafin (a) më sipër.

6. Siguria e digave

Për të garantuar sigurinë e digave, të cilat do të rehabilitohen sipas pjesës 1 të këtij projekti, Huamarrësi, nëpërmjet MBUMK-së kryen ose bën të mundur kryerjen e:

a) krijimin e panelit të ekspertëve të sigurisë së digave, me kualifikime, burime dhe eksperiencë të kënaqshme për Bankën. Ky panel i ekspertëve të sigurisë së digave është përgjegjës për këshillimin e MBUMK-së, për çështje që lidhen me sigurinë e digave në sistemet e përzgjedhura të ujitjes, përfshirë rishikimin e projekteve të zbatimit për rehabilitimin e digave, monitorimin dhe raportimin për punimet rehabilituese të digave dhe përfundimin e punimeve të përmendura më sipër.

b) Përpara fillimit të tenderimit të punimeve që do të realizohen si pjesë e projektit:



i) përgatit, në përputhje me një kuadër të pranueshëm për Bankën, plane të detajuara dhe me afate kohore të qarta, lidhur me digat e përmendura më sipër, për: A) mbikëqyrjen e ndërtimit dhe sigurimin e cilësisë; B) instrumentet; C) operimin dhe mirëmbajtjen; dhe D) përgatitjen për emergjencat; dhe

ii) përfundimin e planeve të përmendura, duke marrë parasysh komentet e Bankës.

Më pas, Huamarrësi, nëpërmjet MBUMK, i zbaton këto plane, të cilat janë pranuar nga Banka.

c) Pas përfundimit të punimeve të ndërtimit në digat përkatëse, caktohen profesionistë të pavarur, të specializuar për realizimin e inspektimeve periodike të sigurisë për digat e përmendura më sipër.

Të përgjithshme

7. Pavarësisht paragrafëve 1 deri në 6 të këtij seksioni I.C, në përjashtim të rasteve kur miratohet nga Banka, Huamarrësi merr përsipër se: a) nuk do të ketë investime në diga dhe në sisteme të reja ujitëse dhe kulluese, ose zgjerim të digave dhe të sistemeve ekzistuese të ujitjes dhe kullimit pjesë e këtij projekti; b) punimet si pjesë e projektit kufizohen në digat dhe sistemet ekzistuese të ujitjes dhe kullimit dhe në zëvendësimin e pajisjeve të vjetra, joefikase ose jofunksionale; dhe c) punimet nuk përfshijnë asnjë shtrirje jashtë digave dhe sistemeve ekzistuese të ujitjes dhe kullimit, rritje të sipërfaqes së ujitshme ose rritje të sasisë së ujit të nxjerrë mbi sasi të miratuara në projektet origjinale të këtyre digave ose sistemeve.

Seksioni II. Raportimi dhe vlerësimi i monitorimit të projektit

A. Raportet e projektit

1. Huamarrësi, nëpërmjet MBUMK-së dhe MMPAU-së, monitoron dhe vlerëson progresin e projektit dhe përgatit raportet e projektit në përputhje me dispozitat e seksionit 5.08 të kushteve të përgjithshme dhe mbi bazën e treguesve të pranuar nga Banka. Çdo raport projekti mbulon një periudhë gjashtëmuajore kalendarike dhe i jepet Bankës jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë pas përfundimit të periudhës së mbuluar nga ky raport.

B. Menaxhimi financiar, raportimi dhe kontrolli financiar

1. Huamarrësi mban ose shkakton mbajtjen e një sistemi financiar menaxhimi në përputhje me dispozitat e seksionit 5.09 të kushteve të përgjithshme.

2. Pa kufizim në dispozitat e pjesës A të këtij seksioni, Huamarrësi, nëpërmjet MBUMK-së dhe MMPAU-së, përgatit dhe i jep Bankës, jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë pas fundit të çdo tremujori kalendarik, raporte të përkohshme financiare të paaudituar për projektin që mbulojnë tremujorëshin në një formë dhe mënyrë të kënaqshme për Bankën.

3. Huamarrësi i auditon pasqyrat financiare në përputhje me dispozitat e seksionit 5.09 (b) të kushteve të përgjithshme. Secili kontroll i pasqyrave financiare mbulon periudhën e një viti fiskal të Huamarrësit (përveç auditit të parë, i cili përfshin po ashtu, të gjithë periudhën gjatë së cilës bëhen tërheqjet sipas pagesës për përgatitjen për projektin), duke filluar me vitin fiskal në të cilin është bërë tërheqja e parë, sipas pagesës për përgatitjen për projektin. Pasqyrat financiare të audituara për secilën nga këto periudha i dërgohen Bankës jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të këtyre periudhave.

Seksioni III. Prokurimi

A. Të përgjithshme

1. Mallrat, punimet dhe shërbimet jokonsulente. Të gjitha mallrat, punimet dhe shërbimet jokonsulente që kërkohen për projektin, të cilat financohen nga shuma e huas, prokurohen në përputhje me kërkesat e përcaktuara ose të përmendura në seksionin I të udhëzimeve të përgjithshme të prokurimeve dhe me dispozitat e këtij seksioni.

2. Shërbimet e konsulentëve. Të gjitha shërbimet e konsulentëve, që kërkohen për projektin dhe që do të financohen nga shuma e huas, prokurohen në përputhje me kërkesat e parashikuara ose të përmendura në seksionin I dhe IV të udhëzimeve të konsulentit dhe me dispozitat e këtij seksioni.

3. Përkufizimet. Termat e shkruar me shkronjë të madhe, të përdorura më poshtë në këtë seksion për të përshkruar metoda të caktuara prokurimi ose metoda të rishikimit nga Banka të kontratave të caktuara, i referohen metodës së përshkruar në seksionin II, III, IV dhe V të udhëzimeve të konsulentit, sipas rastit.

B. Metoda të veçanta të prokurimit të mallrave, punimeve dhe shërbimeve jokonsulente

1. Tenderi i hapur ndërkombëtar. Në përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në paragrafin 2 më poshtë, mallrat, punimet dhe shërbimet jokonsulente prokurohen sipas kontratave të dhëna mbi bazën e tenderit të hapur ndërkombëtar.

2. Metoda të tjera të prokurimit të mallrave, punimeve dhe shërbimeve jokonsulente. Për prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve jokonsulente për kontratat e specifikuar në planin e prokurimeve, të ndryshme nga tenderat e hapura ndërkombëtarë, mund të përdoren dhe metodat e mëposhtme:

a) Tenderi i hapur kombëtar, objekt i dispozitave shtesë të parashikuara në paragrafin 3 më poshtë
b) Blerje
c) Kontraktim i drejtpërdrejtë

3. Modifikim i procedurave të tenderave të hapura kombëtarë. Procedurat e tenderave të hapur kombëtarë (KHT) bazohen në procedurat e tenderave të hapur, siç përcaktohet në ligjin e prokurimeve publike (LPP) të Shqipërisë (ligji nr. 9643, datë 20 nëntor 2006, i ndryshuar), me kusht që kjo procedurë të jetë objekt i dispozitave të seksionit I dhe paragrafëve 3.3 dhe 3.4 të udhëzimeve të prokurimeve dhe dispozitave të mëposhtme shtesë:

i) Procedurat e “Tenderit të hapur”, siç përcaktohen në LPP-në e Shqipërisë zbatohen për të gjitha kontratat e financuara nga Banka;

ii) Ofertuesit e huaj nuk përjashtohen nga tenderimi dhe nuk ka preferenca të asnjë lloji për ofertuesit kombëtarë në procesin e tenderimit. Ndërmarrjet e zotëruara nga shteti në Shqipëri lejohen të japin ofertën e tyre vetëm nëse ato janë ligjërishit dhe financiarisht autonome dhe funksionojnë sipas ligjit tregtar të Republikës së Shqipërisë. Regjistrimi nuk përdoret si kriter kualifikues për ofertuesit;

iii) Ofertat hapen në publik, në një vend, menjëherë pas përfundimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave, në praninë e përfaqësuesve që dëshirojnë të marrin pjesë;

iv) Subjektet prokuresuese përdorin dokumente tip tenderimi, siç miratohet nga Banka;

v) Në rastin e ofertave me çmime më të larta krahasuar me vlerësimin zyrtar, asnjë ofertë nuk skualifikohet pa miratimin paraprak të Bankës;

vi) Për dorëzimin e ofertave përdoret një procedurë me një zarf të vetëm;

vii) Postkualifikimi realizohet vetëm me ofertuesin më të ulët; në kohën e hapjes së ofertave nuk rrëzohet asnjë ofertë për shkak të kualifikimeve;

viii) Ofertuesit në formën e një kompanie aksionare kanë përgjegjësi ligjore të përbashkët dhe të shumëfishtë;

ix) Para skualifikimit të të gjitha ofertave dhe para pranimit të ofertave të reja, merret miratimi paraprak i Bankës;

x) Kontratat i jepen ofertuesit më të ulët, një ofruesi mjaftueshmërisht përgjegjës, i cili përcaktohet se është i kualifikuar për të kryer aktivitetin në përputhje me kriteret e përcaktuara dhe të bëra me dije më parë për vlerësimin;

xi) Negociatat pas ofertimit me ofertën e vlerësuar si më e ulëta ose me ofertues të tjerë nuk lejohen;

xii) Kontratat me kohëzgjatje të gjatë (më tepër se 18 muaj) përmbajnë kushtet e nevojshme për rregullimin e çmimit;



xiii) Ofertat dhe garancitë e kontratave bëhen sipas formatit të përfshirë në dokumentet e tenderit. Garancia e tenderit është e vlefshme për njëzet e tetë ditë (28) përtej vlefshmërisë fillestare të ofertës, ose përtej çdo periudhe zgjatjeje, nëse është e nevojshme. Asnjë pagesë paradhënie nuk mund të bëhet pa një garanci të përshtatshme për paradhënie.

xiv) Dokumentet e tenderimit dhe kontrata, siç konsiderohen të pranueshme për Bankën, përfshijnë dispozitat që deklarojnë politikat e Bankës për të sanksionuar firmat ose individët, të cilët janë identifikuar se janë angazhuar në mashtrim ose korrupsion, siç përkufizohet në udhëzimet e prokurimeve; dhe

xv) Në përputhje me udhëzimet e prokurimeve, çdo dokument tenderues dhe kontratë e financuar me të ardhurat e financimit, parashikon që ofertuesit, furnizuesit dhe kontraktuesit, dhe nënkontraktuesit, agjentët, stafi, konsulentët, ofruesit e shërbimit, ose furnizuesit e tyre, e lejojnë Bankën të inspektojë të gjitha llogaritë, të dhënat dhe dokumentet e tjera të lidhura me ofrimin e ofertave dhe realizimin e kontratës dhe auditin e tyre nga audituesit e caktuar nga Banka. Aktet, të cilat synojnë të pengojnë materialisht ushtrimin e inspektimit dhe të drejtave të auditimit të Bankës, të parashikuara në udhëzimet e prokurimeve, përbëjnë praktikë penguese, siç përcaktohet në udhëzimet e prokurimeve.

C. Metodat e posaçme të prokurimit të shërbimeve të konsulentëve

1. Përzgjedhja bazuar në cilësi dhe në kosto. Në përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në paragrafin 2 më poshtë, shërbimet e konsulentëve prokurohen sipas kontratave të dhëna bazuar në përzgjedhjen e bazuar në cilësi dhe në kosto.

2. Metoda të tjera prokurimi të shërbimeve të konsulentëve. Për prokurimin e shërbimeve të konsulentëve, për ato kontrata të specifikuara në planin e prokurimeve, mund të përdoren metodat e mëposhtme, përveç metodës me përzgjedhje bazuar në cilësi dhe në kosto:

a) Përzgjedhja e bërë bazuar në cilësinë
b) Përzgjedhja sipas një buxheti fiks
c) Përzgjedhja e koston më të ulët
d) Përzgjedhja bazuar në kualifikimet e konsulentëve
e) Përzgjedhja me një burim të vetëm për kompanitë e konsulencës
f) Procedurat e parashikuara në paragrafët 5.2 dhe 5.3 të udhëzimeve të konsulentit për përzgjedhjen e konsulentëve individualë
g) Procedurat me një burim të vetëm për përzgjedhjen e konsulentëve individualë

D. Rishikimi i vendimeve të prokurimeve nga Banka

Plani i prokurimeve përcakton ato kontrata që do të jenë objekt i rishikimit paraprak të Bankës. Të gjitha kontratat e tjera janë objekt i rishikimit të mëpasshëm nga Banka.

Seksioni IV. Tërheqja nga të ardhurat nga huaja

A. Të përgjithshme

1. Huamarrësi mund të tërheqë të ardhurat nga huaja në përputhje me dispozitat e nenit II të kushteve të përgjithshme në këtë seksion dhe me udhëzimet e tjera shpesh të Bankës, siç specifikohen prej saj dhe i njoftohen Huamarrësit (duke përfshirë “Udhëzimet e Bankës Botërore për disbursimet për projektet”, nxjerrë në maj 2006, siç rishikohen herë pas here nga Banka dhe siç zbatohen në këtë marrëveshje në përputhje me këto udhëzime), për financimin e shpenzimeve të ligjshme, siç parashikohet në tabelën në paragrafin 2 më poshtë.

2. Tabela e mëposhtme specifikon kategoritë e shpenzimeve të ligjshme që mund të financohen nga të ardhurat nga huaja (kategori), ndarjen e shumave të huas për secilën kategori dhe përqindjen e shpenzimeve që do të financohen për shpenzimet e ligjshme në secilën kategori.

Kategoria	Shuma e huas së dhënë (shprehur në EUR)	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen (përfshirë taksat)
1) Mallrat, punimet, shërbimet jokonsulente, dhe shërbimet e konsulentëve për:		
a) pjesën 3 të projektit	310,000	
b) pjesë të tjera të projektit	29,592,500	100%
2) kostot operative në rritje	220,000	100%
3) kthimin e pagesës së përgatitjes	800,000	Shuma e paguar në përputhje me seksionin 2.07 (a) të kushteve të përgjithshme
4) tarifën e angazhimit	77,500	Shuma e paguar/tarifa e angazhimit në përputhje me seksionin 2.03 të kësaj marrëveshjeje në përputhje me seksionin 2.07 (b) të kushteve të përgjithshme
Shuma e përgjithshme	31,000,000	

B. Kushtet e tërheqjes, periudha e tërheqjes

1. Pa cenuar dispozitat e pjesës A të këtij seksioni, tërheqja nuk pranohet:

a) për pagesa të bëra para datës së kësaj marrëveshjeje; ose

b) nën kategorinë 1 (a) deri sa të ekzekutohet dhe të ofrohet marrëveshja e bashkëfinancimit dhe deri sa të plotësohen të gjitha kushtet e nevojshme para hyrjes së saj në fuqi, ose para përmbushjes së të drejtës së Huamarrësit për të kryer tërheqje prej saj (e ndryshme nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje).

2. Data e përfundimit është 31 maj, 2018.

Seksioni V. Sipërmarrje të tjera

1. Huamarrësi, nëpërmjet MBUMK-se dhe MMPAU-së:

a) përgatit manualin e zbatimit të projektit, të kënaqshëm për Bankën, i cili duhet të përfshijë: i) politikat dhe procedurat për zbatimin e aktiviteteve të projektit; ii) procedurat e prokurimeve, siç parashikohen në seksionin III të kësaj pjese; iii) kërkesat për monitorim dhe raportim dhe procedurat e menaxhimit financiar, duke përfshirë procedurat e auditimit, siç parashikohen në seksionin II të kësaj pjese; iv) kuadrin e mbrojtjes mjedisore dhe sociale; dhe v) kuadrin e politikave për zhvendosjet.

b) realizon projektin dhe bën të mundur realizimin e projektit, në përputhje me manualin e zbatimit të projektit, të cilin Banka e ka konfirmuar si të kënaqshëm (manuali i zbatimit të projektit); dhe

c) nuk ndryshon, fshin ose heq asnjë pjesë të manualit të zbatimit të projektit, pa miratimin paraprak të Bankës.

2. Huamarrësi bie dakord që për çdo ndryshim në tabelën e detajuar të kostove të bihet dakord ndërmjet MF-së, MBUMK-së dhe MMPAU-së para zbatimit të këtyre ndryshimeve.



PJESA 3 AFATI I AMORTIZIMIT

Tabela e mëposhtme përcakton datat e pagesës së principalit të huas dhe përqindjen e shumës së përgjithshme të principalit të paguar në çdo datë pagese principali (pjesa e këstit). Nëse të ardhurat e huas janë tërhequr të tëra që prej datës së pagesës së principalit, shuma e principalit të huas së ripagueshme nga Huamarrësi për secilën datë pagese principali do të përcaktohet nga Banka duke llogaritur: a) bilancin e huas së tërhequr që prej datës së pagesës së principalit; nga b) pjesa e këstit për secilën datë pagimi të principalit; kjo shumë e ripagueshme rregullohet, sipas nevojës, për të zbritur shumat e përmendura në paragrafin 4 të kësaj pjese, në të cilën zbatohet konvertimi i monedhës.

Data e pagimit të principalit	Pjesa e këstit (e shprehur në përqindje)
Çdo 15 shkurt dhe 15 gusht	
Fillimi 15 shkurt, 2020	3.13%
Deri më 15 shkurt, 2035	
Më 15 gusht, 2035	2.97%

2. Nëse të ardhurat nga huaja nuk janë tërhequr plotësisht në datën e pagimit të principalit, shuma e ripagueshme e principalit të huas për Huamarrësin për secilën datë pagimi principali do të përcaktohet si më poshtë:

a) kur të ardhurat nga huaja janë tërhequr që prej datës së parë të pagimit të principalit, Huamarrësi paguan balancën e tërheqjes së huas që prej kësaj dite, në përputhje me paragrafin 1 të kësaj pjese;

b) çdo shumë e tërhequr pas datës së pagimit të principalit ripaguhet në secilën datë të pagimit të principalit, pas datës së kësaj tërheqjeje në shuma që përcaktohen nga Banka, duke e shumëzuar shumën e secilit prej këtyre tërheqjeve me një fraksion, emëruesi i të cilit është pjesa e këstit origjinal, e specifikuar në tabelën në paragrafin 1 të kësaj pjese për datën e pagimit të principalit (pjesa fillestare e këstit) dhe me numërues shumën e të gjitha pjesëve fillestare të këstit për datat e pagimit të principalit që bien brenda kësaj date ose pas kësaj date ëkëto shuma për ripagim rregullohen, sipas nevojës, për të zbritur shumat e përmendura në paragrafin 4 të kësaj pjese, për të cilën zbatohet konvertimi i monedhës].

3. a) Shumat e huas, të tërhequra brenda dy muajve kalendarikë para datës së pagimit të principalit, për qëllime vetëm të përlllogaritjes së shumave të principaleve të paguara në datën e pagimit të principalit, trajtohen si të tërhequra në datën e dytë të pagesës së principalit, pas datës së tërheqjes dhe ripaguhet në çdo datë pagese principali, që fillon me datën e dytë të pagesës së principalit, pas datës së tërheqjes.

b) Pa cenuar dispozitat e nënparagrafit (a) të këtij paragrafi, nëse në çdo kohë Banka miraton një sistem të përshtatshëm faturimi, sipas të cilit lëshohen faturat në datën përkatëse të pagimit të principalit ose pas kësaj date, dispozitat e këtij paragrafi nuk zbatohen më për asnjë tërheqje të bërë pas miratimit të një sistemi të tillë faturimi.

4. Pa cenuar dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të kësaj pjese, me konvertimin e monedhës së të gjithë bilancit të tërhequr të huas ose të një pjese të tij, në një monedhë të miratuar, shuma e konvertuar në monedhën e miratuar që ripaguhet në datën e pagimit të principalit që del gjatë periudhës së konvertimit, përcaktohet nga Banka, duke e shumëzuar këtë shumë me shifrën e përcaktuar menjëherë para konvertimit ose me: i) kursin e këmbimit që reflekton shumat e principalit në monedhën e miratuar të paguar nga Banka sipas transaksionit të këmbimit që lidhet me konvertimin; ose ii) në rast se përcaktohet nga Banka, në përputhje me udhëzimet e konvertimit, me nivelin valutor që është komponent i nivelit të përcaktuar (Screen Rate).

5. Nëse bilanci i tërheqjes së huas përcaktohet në më shumë se në një monedhë, dispozitat e kësaj pjese zbatohen veçmas për shumat e caktuara në secilën monedhë huaje, në mënyrë që të prodhohet një skemë e veçantë amortizimi për secilën nga shumat.

SHTOJCË

Seksioni I. Përkufizime

1. “Udhëzimet antikorrupsion” janë “Udhëzimet për parandalimin dhe luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit në projektet e financuara nga huat e IBRD-së dhe kreditë dhe grantet e IDA-s”, datë 15 tetor 2006, rishikuar në janar të vitit 2011.

2. “Kategori” është kategoria e parashikuar në tabelën në seksionin IV të pjesës 2 të kësaj marrëveshjeje.

3. “Bashkëfinancues” është Suedia.

4. “Bashkëfinancim”, në kuptimin e paragrafit 16 të shtojcës në kushtet e përgjithshme, është shuma ekuivalente me pesë milionë dollarë, e cila ofrohet nga bashkëfinancuesi për të ndihmuar financimin e projektit.

5. “Marrëveshje bashkëfinancimi” është marrëveshja që do të nënshkruhet ndërmjet Huamarrësit dhe bashkëfinancuesit që do të japë bashkëfinancimin.

6. “Udhëzimet e konsulentit” janë “Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve për huat e IBRD-së dhe për kreditë dhe grantet e IDA-s nga Huamarrës të Bankës Botërore”, nxjerrë në janar të vitit 2011.

7. “Tabela e detajuar e kostove” është tabela e detajuar e kostove, datë 10 tetor 2012 e rënë dakord ndërmjet MF-së, MBUMK-së dhe MMPAU-së.

8. “Personat e zhvendosur” janë personat, të cilët, për shkak të ekzekutimit të projektit, kanë qenë objekt ose do të jenë objekt i ndikimeve të drejtpërdrejta ekonomike dhe sociale, të shkaktuara nga: a) marrja jovullnetare e tokës, e cila çon në: i) rivendosje ose humbje strehimi; ii) humbje të aseteve ose të aksesit në asete; ose iii) humbje të burimeve të të ardhurave ose të mjeteve të jetesës, pavarësisht nëse këta persona duhet ose jo të lëvizin në një vend tjetër; ose b) kufizim jovullnetar në aksesin në zonat e përcaktuara ligjshmërisht, si parqe dhe në zonat e mbrojtura, të cilat çojnë në rezultate negative mbi jetën e këtyre personave.

9. “Kuatridi i mbrojtjes mjedisore dhe sociale” është kuatridi i mbrojtjes mjedisore dhe sociale, datë 1 tetor 2012, i cili përcakton politika dhe procedura për shqyrtimin e aktiviteteve të propozuara të projektit (duke përfshirë rehabilitimin dhe modernizimin e digave dhe të sistemeve të ujitjes dhe të kullimit) dhe për përgatitjen e planeve të zonave specifike për menaxhimin mjedisor dhe social gjatë zbatimit të projektit, siç mund të ndryshohen herë pas here, dokumente të tilla në marrëveshje me Bankën.

10. “Kushtet e përgjithshme” janë “Kushtet e përgjithshme të Bankës Ndërkombëtare për Zhvillim dhe Integrim për huat”, datë 12 mars 2012.

11. “Kostot operative rritëse” janë kostot administrative me rritje të arsyeshme graduale të MBUMK-së dhe MMPAU-së] administrimit, të shoqëruara me zbatimin e aktiviteteve të projektit, duke përfshirë mirëmbajtjen e zyrave, pajisjet, materialet dhe furnizimet, kostot e komunikimit dhe kostot e karburantit për vizitat në terren.

12. “MBUMK” është Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të Huamarrësit ose çdo zëvendësues i ardhshëm i saj.

13. “MMPAU” është Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujit të Huadhënësit, ose çdo zëvendësues i ardhshëm i saj.

14. “Këshilli Kombëtar i Ujit” është Këshilli Kombëtar i Ujit, i cili është organi qendror vendimmarrës për menaxhimin e burimeve ujore, i krijuar në përputhje me ligjin nr. 8093, datë 21 mars 1996.



15. “Paneli i ekspertëve të sigurisë së digave” është paneli prej pesë (5) ekspertësh të fushave të ndryshme teknike, të lidhura me aspektet e sigurisë së digave në sistemet e përzgjedhura të ujitjes, panel i krijuar në përputhje me kushtet e punës të pranueshme për Bankën, në mënyrë që të shqyrtojë çështjet që lidhen me sigurinë e digave dhe këshillohet me MBUMK-në në lidhje me to.

16. “Pagesa për përgatitjen” është parapagimi i përmendur në seksionin 2.07 (a) të kushteve të përgjithshme, i dhënë nga Banka për Huamarrësin, në përputhje me letrën e marrëveshjes, nënshkruar në emër të Bankës më 4 qershor 2010 dhe në emër të Huamarrësit më 26 gusht 2010.

17. “Udhëzimet e prokurimeve” janë “Udhëzimet: prokurimet e mallrave, e punimeve dhe të shërbimeve jokonsulente për huat e IBRD-së dhe kreditë dhe grantet e IDA-s nga Huamarrësit e Bankës Botërore”, nxjerrë në janar 2011.

18. “Plani i prokurimeve” është plani i prokurimeve të Huamarrësit për projektin, datë 10 tetor 2012 dhe përmendur në paragrafin 1.18 të udhëzimeve të prokurimit dhe paragrafit 1.25 të udhëzimeve të konsulentit, siç përditësohet herë pas here në përputhje me dispozitat e paragrafëve të përmendur më sipër.

19. “Agjencitë e baseneve të lumenjve” janë agjencitë e baseneve të lumenjve, të krijuara në përputhje me ligjin nr. 8093, datë 21 mars 1996, me përgjegjësi të lidhura me burimet ujore, duke përfshirë mbajtjen e inventarëve dhe hartimin e propozimeve për inventarë dhe propozimin e investimeve dhe menaxhimit, duke i kushtuar vëmendje uljes së ndotjes dhe trajtimit të problemeve.

20. “Këshillat e baseneve të lumenjve” janë këshillat e baseneve të lumenjve, të krijuara në përputhje me ligjin nr. 8093, datë 21 mars 1996, përgjegjësitë e të cilëve do të përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Ujit.

21. “Manuali i zbatimit të projektit” është manuali për veprimet e projektit, i përgatitur në përputhje me paragrafin 1 të seksionit V të pjesës 2 të kësaj marrëveshje dhe i konfirmuar si i kënaqshëm nga Banka, i miratuar nga Huamarrësi në përputhje me seksionin 4.01 (d) të kësaj marrëveshjeje.

22. “Kudri i politikave të zhvendosjes” është kudri i politikave të zhvendosjes, datë 9 tetor 2012, i cili përcakton politikat dhe procedurat për marrjen e tokës dhe të aseteve të tjera, zhvendosjen, kompensimin dhe rehabilitimin e personave të zhvendosur dhe procedurat për përgatitjen e planeve të zhvendosjes për zonat specifike, kurdo që kërkohet gjatë zbatimit të projektit, siç mund të ndryshohet herë pas here me miratimin paraprak të Bankës.

23. “Sistemet e përzgjedhura të ujitjes” janë: a) digat e mëposhtme dhe sistemet e tyre përkatëse të ujitjes dhe të kullimit: T’Plani, Vranishti 2, Tregtani 2, Tregtani 3, Murriz Thana, Kurjani, Strumi, Zharreza, Slanica, Belesova, Duhanasi, Staravecka, Leminoti dhe Koshnica; b) sistemet e ujitjes dhe të kullimit të Bushatit dhe Xarrës; si dhe c) çdo digë dhe/ose sistem ujitjeje dhe kullimi, për të cilin bihet dakord ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës.

LIGJ
Nr. 90/2013

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË NDRYSHIMET E NENEVE TË
MARRËVESHJES SË THEMELIT TË BANKËS SË DETIT TË ZI PËR TREGTI
DHE ZHVILLIM (BSTDB)**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në ndryshimet e neneve të marrëveshjes së themelimit të Bankës së Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim (BSTDB), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratur në datën 21.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7963, datë 27.2.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

REZOLUTË E BORDIT TË GUVERNATORËVE

Rezolutë nr. 131

Lënda: Aprovimi i një projektrezolute të Bordit të Guvernatorëve në lidhje me ndryshimet e propozuara për marrëveshjen themeluese (euro)

Guvernatorët, pasi shqyrtuan propozimet e paraqitura Bordit në pajtim me rezolutën nr. 126, të aprovuar në mbledhjen e veçantë të 8-të të Bordit të Guvernatorëve më 5 dhjetor 2010, dhe në pajtim me nenet 23,2 (a), 24.3 dhe 54 të marrëveshjes,

VENDOSËN ME KONSENSUS,

Aprovimin e ndryshimeve të mëposhtme të marrëveshjes (bashkërisht “**ndryshimi**”):

- Paragrafi 1 i nenit 4 të marrëveshjes ndryshohet për të zëvendësuar germën e vogël “t” me germën e madhe “T” në nenin në fillim të paragrafit dhe për të futur fjalët e mëposhtme menjëherë para saj: “**Në pajtim me nënparagrafin (m) të paragrafit 2 të nenit 23,**”.

- Paragrafi 2 i nenit 23 të marrëveshjes ndryshohet, duke ndryshuar pikën (.) me një pikëpresje (;) në fund të nënparagrafit (1) të tij dhe duke futur nënparagrafin e ri të mëposhtëm (m) menjëherë para tij: “**Ndryshon njësinë e llogarisë së Bankës, ripërcakton të gjithë gjendjen e kapitalit të Bankës, dhe përcakton numrin sipas vlerës të pjesëve në të cilat ai ndahet, siç mund të jetë e këshillueshme.**”.



- Paragrafi 3 i nenit 24 i marrëveshjes ndryshohet duke fshirë fjalën “dhe” dhe para “(k)”, duke futur një presje (,) në vend të saj dhe duke shtuar fjalët “**dhe (m)**” para fjalëve “të nenit 23”.

Udhëzimin e menaxhimit të Bankës për të dërguar menjëherë komunikimin zyrtar të parashikuar nga neni 54 i marrëveshjes të të gjithë anëtarët, duke certifikuar aprovimin e ndryshimit në pajtim me paragrafin 3 të nenit 24 të marrëveshjes dhe **duke deklaruar** që Bordi i Guvernatorëve specifikon që ndryshimi hyn në fuqi për të gjithë anëtarët e Bankës në datën (**data e hyrjes në fuqi**), ku Banka ka marrë konfirmimin zyrtar nga secili guvernator që anëtari që ajo/ai përfaqëson, ka përfunduar të gjitha veprimet e konsideruara të nevojshme në pajtim me sistemin e tij ligjor për sa i takon ndryshimit.

Që nga dhe duke përfshirë datën e hyrjes në fuqi, i) **njësia e llogarisë së Bankës është euro-ja**; ii) **e gjithë gjendja e kapitalit të Bankës do të përcaktohet në euro**; iii) **gjendja e kapitalit të autorizuar** të Bankës është një shumë që është e barabartë me tre bilionë, shumëzuar me kursin e këmbimit SDR/EURO në datën e hyrjes në fuqi, sipas përcaktimit nga FMN-ja (**norma e konvertimit**), ndarë në tre milionë (3,000,000) pjesë që kanë një vlerë barabartë me shumën e kapitalit të autorizuar, të ndarë me tre milionë (3,000,000); dhe iv) **të gjitha detyrimet kapitale SDR të pashlyera të anëtarëve, në lidhje me pjesët e pagueshme dhe të pritshme konvertohen dhe përcaktohen në euro me normën e konvertimit.**

Aprovuar më 19 qershor 2011 në mbledhjen vjetore të 13-të të Bordit të Guvernatorëve në Tiranë, Shqipëri.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 27.2.2013
Doli nga shtypi më 28.2.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 48 lekë